

**PËRPUTHSHMËRIA
E PRIORITETEVE
TË QEVERISË QENDRORE
ME ATO TË QEVERIVE
LOKALE TË RAJONIT
QENDËR**

Financuar nga:
Zyra e BE-së në Kosovë



Deklaratë mohimi:

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Institutit Riinvest dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Kontribuuesit:

Antigona Uka, Enisa Serhati, Ylli Tafarshiku,
Ilire Mehmeti, Alban Hashani dhe Lumir Abdixhiku

Dizajni dhe Faqosja:

Faton Selani

Origjinali është shkruar në shqip

Publikuar nga:

INSTITUTI RIINVEST
Lidhja e Prizrenit nr. 42
Prishtinë 10000, Republika e Kosovës
Tel: + 381 (0)38 244320; 223816
www.riinvestinstitute.org



E drejta autoriale © 2016 nga INSTITUTI RIINVEST. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem riprodhimi, apo të transmetohet, në asnjë formë apo nga asnjë mjet, qoftë elektronik, apo mekanik, fotokopjues, regjistruar apo tjetër, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6	6. Komuna E GRAÇANICËS	34
HYRJA.....	7	6.1. Kapitali njerëzor	35
1. METODOLOGJIA	8	6.2. Industritë konkurruese.....	36
		6.3. Infrastruktura	37
		6.4. Bujqësia	38
2. Komuna E PRISHTINËS.....	10	7. Komuna E LIPJANIT	40
2.1. Kapitali njerëzor	11	7.1. Kapitali njerëzor	41
2.2. Industritë konkurruese.....	12	7.2. Industritë konkurruese.....	42
2.3. Infrastruktura	13	7.3. Infrastruktura	43
2.4. Bujqësia	14	7.4. Bujqësia	44
3. Komuna E PODUJEVËS.....	16	8. Komuna E DRENASIT	46
3.1. Kapitali njerëzor	17	8.1. Kapitali njerëzor	47
3.2. Industritë konkurruese.....	18	8.2. Industritë konkurruese.....	48
3.3. Infrastruktura	19	8.3. Infrastruktura	49
3.4. Bujqësia	20	8.4. Bujqësia	50
4. Komuna E FUSHË KOSOVËS	22	9. Komuna E SHTIMES.....	52
4.1. Kapitali njerëzor	23	9.1. Kapitali njerëzor	53
4.2. Industritë konkurruese.....	24	9.2. Industritë konkurruese.....	54
4.3. Infrastruktura	25	9.3. Infrastruktura	55
4.4. Bujqësia	26	9.4. Bujqësia	56
5. Komuna E OBILIQIT	28	PËRMBYLLJA.....	58
5.1. Kapitali njerëzor	29	REFERENCAT	60
5.2. Industritë konkurruese.....	30	SHTOJCA.....	61
5.3. Infrastruktura	31		
5.4. Bujqësia	32		

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Qëllimi i këtij studimi është të identifikojë dhe vlerësojë përputhshmërinë e prioriteteve të zhvillimit rajonal (konkretisht të Komunave të rajonit ekonomik Qendër) dhe prioriteteve kombëtare të vendosura nga Qeveria qendrore.

Metodologjia e përdorur në realizimin e studimit ka është bazuar në vlerësimin e përfaqësuesve nga qeverisja lokale, përkatësisht vlerësimin e zyrtarëve Komunal për përputhshmërinë në planifikimin për zhvillim në nivel kombëtar dhe lokal. Për të arritur këtë vlerësim zyrtarët Komunal kanë analizuar koherencën e prioriteteve të Komunave krahas atyre qeveritare në katër kategori për zhvillim: zhvillimi i kapitalit njerëzor, zhvillimi i industrive konkurruese, zhvillimi i infrastrukturës, dhe zhvillimi i bujqësisë.

Nga ky vlerësim doli se në përgjithësi ka një përputhshmëri jo të lartë mes prioriteteve të Komunave të rajonit Qendër dhe prioriteteve të Qeverisë qendrore. Posaçërisht, ka një mungesë të përputhshmërisë në kategoritë e zhvillimit të infrastrukturës dhe zhvillimit të bujqësisë. Në këto dy kategori përputhshmëria është vlerësuar si shume e ulët në të gjitha Komunat (me përjashtim të zhvillimit të infrastrukturës në Graçanicë). Përputhshmëria vlerësohet të jetë më e lartë (mesatare ose mbi mesatare) në kategoritë e zhvillimit të kapitalit njerëzor dhe zhvillimit të industrive konkurruese për Komunat e Prishtinës, Podujevës, dhe Graçanicës. Për më tepër, një koherencë minimale ekziston mes prioriteteve të qeverisjes lokale dhe atyre të Qeverisë qendrore në komunën e Fushë Kosovës dhe komunën e Drenasit, ku përputhshmëria e prioriteteve është vlerësuar si minimale në të gjitha kategoritë e zhvillimit.

Sigurisht, gjetja e një mungese të përputhshmërisë së prioriteteve në dy nivelet e qeverisjes në vetvete nuk është dëshmi e plotë e mungesës së një kontributi të përbashkët të Komunave dhe Qeverisë drejt një zhvillimi kombëtar. Por, mungesa e përputhshmërisë është një indikator i qartë që në planifikim strategjik të niveleve të ndryshme të qeverisjes mungon koordinim që do të stimulonte një sinergji të zhvillimit kombëtar.

Përgjithësisht, ndërlidhja e prioriteteve qendrore në raport me prioritetet Komunale ka hapësirë për bashkërendim, për shkak se

të dhënat nga intervistat sugjerojnë që bashkëpunimi mes nivelit qendror dhe Komunal në shumicën e rasteve është i kënaqshëm, por që ky bashkëpunim mund të ngritët. Kështu, kjo përkon edhe me qëllimin e përcaktuar në SKZH për krijimin e një boshti të përbashkët orientues të bazuar në strategjitë dhe politikat ekzistuese, për të përzgjedhur 'prioritetet më të larta të vendit'.

Prandaj, rekomandimi kryesor është krijimi i një modaliteti të bashkëpunimit mes Qeverisë dhe Komunave për të identifikuar hapësirat për planifikim të përbashkët zhvillimor që do të asistonte në një rritje ekonomike dhe zhvillim të përsheptuar. Kjo mund të arrihet përmes takimeve sistematike dhe bashkëpunimit gjatë hartimit të dokumenteve strategjike duke u mbështetur në një kuadër ligjor që mundëson dhe obligon një koordinim të tillë.

HYRJA

Qëllimi i këtij studimi është të identifikojë dhe vlerësojë përputhshmërinë e prioriteteve të zhvillimit rajonal (konkretisht rajonit ekonomik Qendër) dhe prioriteteve kombëtare të adresuara nga Qeveria qendrore¹.

Identifikimi i prioriteteve të Komunave në rajonin Qendër është bërë i mundur përmes dokumenteve strategjike të hartuara nga vetë Komunat, si dhe janë mbledhur informata për prioritete kryesisht nga intervistat me zyrtarë të drejtorive të Zhvillimit Ekonomik, të Arsimit, dhe të Bujqësisë.

Identifikimi i prioriteteve qendrore është bërë përmes konsultimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021, strategji e cila është miratuar nga Qeveria në Janar të vitit 2016. Prioritetet e SKZH hyjnë në katër shtyllat tematike: zhvillimi i kapitalit njerëzor, zhvillimi i industrive konkurruese, zhvillimi i infrastrukturës, si dhe sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë. Ndërsa, ky studim mbulon tri nga shtyllat e SKZH-së të cilat janë konsideruar të krahasueshme me prioritetet lokale dhe që duhet të pasqyrohen në nivelin lokal, gjegjësisht kapitali njerëzor, zhvillimi i industrive konkurruese dhe zhvillimi i infrastrukturës. Brenda prioriteteve të SKZH-së për këtë studim janë nxjerrë edhe prioritetet që hyjnë në kuadër të zhvillimit të bujqësisë dhe është vlerësuar rëndësia dhe përputhshmëria e tyre krahas prioriteteve lokale.

Studimi ka analizuar po ashtu planet afatshkurta dhe afatmesme dhe veprimet zhvillimore të nivelit lokal që ndërlidhen me ato të nivelit qendror, duke përfshirë alokimet buxhetore, grantet dhe projektet. Hartimi i raportit është bazuar në të dhëna kuantitative dhe kualitative të mbledhura përmes intervistave me zyrtarë të Komunave të rajonit Qendër, si dhe përmes dokumenteve strategjike të disponueshme në faqet zyrtare të institucioneve publike.

Ky studim është i organizuar në këtë mënyre: seksioni i parë paraqet metodologjinë e hulumtimit. Këtu është përshkruar në mënyrë të detajuar procesi i hulumtimit, duke përfshirë edhe procesin e identifikimit të prioriteteve brenda sektorëve të lartpërmendur. Pjesa e dytë është e ndarë në dy nën-seksione për çdo komunë të rajonit Qendër; ku nën-seksioni i parë paraqet analizën e të dhënave dytësore nga strategjitë zhvillimore të këtyre Komunave, kurse nën-seksioni i dytë paraqet gjetjet nga intervistat e zhvilluara me zyrtarët Komunal të Komunave. Seksioni i tretë paraqet, në mënyrë të sintetizuar, përfundimet e nxjerra nga studimi.

¹Rajoni ekonomik Qendër përfshin këto Komuna të Kosovës: Prishtinë, Podujevë, Fushë Kosovë, Obiliq, Graçanicë, Lipjan, Drenas dhe Shtime.

1. METODOLOGJIA

Qëllimi i këtij studimi është të identifikojë dhe vlerësojë përputhshmërinë e prioriteteve të zhvillimit rajonal dhe prioriteteve kombëtare të adresuara nga Qeveria qendrore. Studimi ka analizuar planet afatshkurta dhe afatmesme dhe veprimet zhvillimore të nivelit lokal që ndërlidhen me ato të nivelit qendror, duke përfshirë alokimet buxhetore, grantet dhe projektet. Hartimi i raportit është bazuar në të dhëna kuantitative dhe kualitative të mbledhura përmes intervistave me zyrtarë të Komunave të rajonit Qendër, si dhe përmes dokumenteve strategjike të disponueshme në faqet zyrtare të institucioneve publike.

Identifikimi i prioriteteve qendrore është bërë përmes konsultimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016–2021, strategji e cila është miratuar nga Qeveria në Janar të vitit 2016. Kjo strategji ka për fokus krijimin e një boshti të përbashkët orientues të bazuar në strategjitë dhe politikat ekzistuese, duke përzgjedhur 'prioritetet më të larta të vendit'. Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) (2016–2021) është pikërisht kjo listë e prioriteteve të larta. Prioritetet e SKZH-së hyjnë në katër shtyllat tematike: zhvillimi i kapitalit njerëzor, zhvillimi i industrive konkurruese, zhvillimi i infrastrukturës, si dhe sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë. Ndërsa, ky studim mbulon tri nga shtyllat e SKZH-së të cilat janë konsideruar të krahasueshme me prioritetet lokale dhe që duhet pasqyrohen në nivelin lokal, gjegjësisht kapitali njerëzor, industritë konkurruese dhe zhvillimi i infrastrukturës. Për më tepër, në mënyrë specifike është matur përputhshmëria e prioriteteve të bujqësisë mes nivelit qendror dhe atij lokal. Kështu, brenda prioriteteve të SKZH-së për këtë studim janë nxjerrë objektivat që hyjnë në kuadër të zhvillimit të bujqësisë dhe është vlerësuar rëndësia e tyre krahas prioriteteve lokale.

Në anën tjetër, identifikimi i prioriteteve të Komunave në rajonin Qendër është bërë i mundur përmes dokumenteve strategjike të hartuara nga vetë Komunitat, si dhe janë mbledhur informata për prioritetet kryesisht nga intervistat me zyrtarë të drejtorive të Zhvillimit Ekonomik, të Arsimit, dhe të Bujqësisë. Të njëjtit, kanë vlerësuar rëndësinë dhe përputhshmërinë e prioriteteve qendrore krahas atyre lokale duke vlerësuar me shkallë prej një deri në nëntë (ku një paraqet rëndësi më të ulët, ndërsa nëntë rëndësi më të lartë). Kjo matje e rëndësisë është bërë

përmes intervistave të drejtpërdrejta, udhëhequr nga një pyetësor i cili ka përfshirë tri seksione: 1) Strategjia Komunale për zhvillim sektorial, 2) Vlerësimi i prioriteteve sektoriale, dhe 3) Bashkëpunimi i qeverisë qendrore me atë Komunale. Krahas pyetjeve kualitative brenda pyetësorit, përfshihen edhe matricat e sektorëve 1) zhvillimi i kapitalit njerëzor, 2) zhvillimi i industrive konkurruese, 3) zhvillimi i infrastrukturës, si dhe 4) zhvillimi i bujqësisë, të cilat paraqesin komponentën kuantitative të pyetësorit.

Përveç intervistave, të dhënat dytësore janë shfrytëzuar për qëllim të studimit. Të dhënat dytësore përfshijnë botimet zyrtare të institucioneve të mëposhtme: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministrinë relevante, Komunitat e rajonit Qendër si dhe OJQ-të siç është Instituti GAP dhe organizata të tjera të cilat kanë nxjerrë studime relevante.

Pas grumbullimit të të dhënave, është përgatitur raporti i detajuar mbi përputhshmërinë e prioriteteve qendrore me ato lokale, alokimin e buxhetit nëpër sektorët e përcaktuar, dhe nivelin e bashkëpunimit të qeverisjes qendrore me atë lokale. Kështu, të gjeturat e studimit nxjerrin rekomandime të rëndësishme të cilat mund të përdoren për të krijuar sinergji mes aktiviteteve qeveritare dhe Komunale.

Në fund, duhet cekur që edhe pse hartimi i këtij studimi është bërë me kujdes dhe ka kaluar disa faza të redaktimit, ende mbeten mangësi dhe hapësira për të u përmirësuar në studimet e ardhshme. Një element karakterizues i metodologjisë së studimit është fakti që analizimi i përputhshmërisë së prioriteteve qendrore dhe lokale është bërë përmes vlerësimit të të dhënave nga zyrtarët e Komunave të regjionit Qendër. Pra, duhet pasur parasysh gjatë interpretimit të rezultateve se përputhshmëria e prioriteteve të rajonit Qendër në raport me ato të Qeverisë qendrore në studim gjithnjë tregon perspektivën e Komunave, gjegjësisht zyrtarëve të intervistuar.





2. KOMUNA E PRISHTINËS

Prioritetet e Komunës së Prishtinës për periudhën 2016-2018 janë:

1. **Vendosja e rregullit urban**, që përfshin planifikim hapësinor, i cili sipas rezultatit të intervistave me zyrtarët e Komunës së Prishtinës është në funksion të krijimit të hapësirave publike dhe po ashtu në funksion të ndërtimit, si sektor shumë i rëndësishëm për zhvillim. Ky prioritet po ashtu i mundëson Komunës krijimin e një plani të mobilitetit në qytet, plan ky i cili përfshin transport publik, çiklizëm, dhe të tjera.
2. **Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë** përmes ndërrimit të formës së përkrahjes të sektorit të bujqësisë, rrjedhimisht kalimit nga subvencioni i fermerëve në formë direkte, në dhënieve të granteve përmes fondit zhvillimor rural.
3. **Nën-kontraktimi i shërbimeve**, apo shndërrimi i Prishtinës në qendër të eksportit të shërbimeve me anë të kontraktimit të kapitalit punëtor vendor, nga kompanitë jashtë Kosovës ("outsourcing"), përmes subvencionimit të qirave të kompanive, dhe përkrahjes me trajnime me anë të stafit për zhvillim të karrierës.

Nga intervista e zhvilluar me zyrtarët e Komunës së Prishtinës, doli se këto prioritetet janë përcaktuar duke u bazuar në planin elektoral të Kryetarit të Komunës, rrjedhimisht 12 shtyllave të qeverisjes, të cilat ndër të tjera përfshijnë: vendosje të rregullit në planifikim urban, rregullim të trafikut në Prishtinë, krijimin e tregut të prodhimeve të vendit, hapjen e Komunës për qytetarë dhe të tjera. Këto 12 shtylla pjesë e planit elektoral prej të cilave derivojnë prioritetet Komunale, kanë dalë duke u bazuar në nevojat e qytetarëve të Komunës së Prishtinës.

Prioritetet e lartpërmendura janë ancoruar në Planin Zhvillimor Komunal të adaptuar në vitin 2013. Sipas zyrtarëve të Komunës së Prishtinës, Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal nuk është e përditësuar, për këtë arsye Qeveria lokale i referohen planit zhvillimor elektoral, i cili përfshin edhe 12 shtyllat e përmendura.

Zyrtari i Komunës së Prishtinës ka deklaruar se duke pasur parasysh arritjet e deri tanishme në Komunën e Prishtinës dhe përmeshjen e një pjese të madhe të premtimeve elektorale, strategjia është e realizueshme, ndërsa ata janë optimistë që strategjia do të zbatohet brenda periudhës së caktuar kohore, me mjetet financiare në dispozicion.

2.1 Kapitali njerëzor

Në pjesën në vijim, zyrtarët e komunës së Prishtinës kanë renditur prioritetet më të rëndësishme për zhvillimin e kapitalit njerëzor, ndërsa më pas, kanë vlerësuar se sa përputhen këto prioritetet me prioritetet e nivelit qendror në një shkallë prej një deri në nëntë. Sa i përket zhvillimit të kapacitetit njerëzor, në Komunën e Prishtinës si prioritet i parë është vendosur 'Hapja e çerdheve në komunitet'. Në raport me këtë prioritet Komunal, me rëndësi të madhe dhe në përputhshmëri të plotë është konsideruar prioriteti qeveritar 'Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucione parashkollore', përkatësisht vlerësuar me nëntë pikë. Përderisa, gjashtë prioritet qeveritare të radhës si 'Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm', 'Përmirësimi i ndërlidhjes ndërmjet shkathtësive të fituara në arsim dhe kërkesave të tregut të punës', 'Forcimi i funksioneve të provimit, inspektimit dhe akreditimit në sistemin arsimor', 'Përmirësimi i planifikimit të shpenzimeve në sistemin

e arsimit', dhe 'Ulja e nivelit të punësimit joformal', janë vlerësuar me shkallën më të ulët të përputhshmërisë.

Si prioritet i dytë Komunal lidhur me zhvillimin e kapitalit njerëzor është renditur 'Ndërlidhja e shkollave profesionale me treg të punës'. Sa i përket rëndësisë dhe përputhshmërisë mes prioritetit të dytë Komunal dhe prioritetit qeveritar 'Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucione parashkollore', ky prioritet është vlerësuar i një rëndësie të ulët. Ndërkohë dy prioritetet qeveritare si 'Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm' dhe 'Përmirësimi i ndërlidhjes ndërmjet shkathtësive të fituara në arsim dhe kërkesave të tregut të punës', janë vlerësuar me rëndësi të madhe. Me rëndësi relativisht të madhe janë konsideruar edhe prioritetet tjera qeveritare (siç mund të shihet në Matricën 1).

MATRICA 1: KAPITALI NJERËZOR – KOMUNA E PRISHTINËS

	Qeveria	Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucione parashkollore	Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm	Përmirësimi i ndërlidhjes ndërmjet shkathtësive të fituara në arsim dhe kërkesave të tregut të punës	Forcimi i funksioneve të provimit, inspektimit dhe akreditimit në sistemin arsimor	Përmirësimi i planifikimit të shpenzimeve në sistemin e arsimit	Ulja e nivelit të punësimit joformal	Angazhimi afatshkurter i ekspertëve dhe studentëve të diasporës
Hapja e çerdheve në komunitet	9	1	1	1	1	1	1	7
Ndërlidhja e shkollave profesionale me treg të punës	1	8	9	6	7	8	8	7
Departizimi i institucioneve shkollore	1	8	8	8	7	2	2	2
Ngritja e kapaciteteve të mësimdhënies (laboratore, biblioteka)	2	8	8	6	5	4	4	5



VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)



2.2 Industritë konkurruese

Vlerësime të tilla janë bërë edhe me industritë konkurruese. Prioritet i parë Komunal është radhitur 'Nën-kontraktimi i shërbimeve (outsourcing)'. Si prioritet i parë qeveritar lidhur me industritë konkurruese është 'Lehtësimi i qasjes në financa për ndërmarrjet kosovare', i cili është vlerësuar të një rëndësie mesatare.. Tri prioritetet tjera qeveritare si 'Rrjetëzimi dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të grupuara', 'Kalimi i NVM-ve në aktivite me vlerë më të lartë të shtuar', dhe 'Rritja e nivelit të

Investimeve të Huaja Direkte (IHD) dhe atyre të diasporës' janë konsideruar me rëndësi më të madhe dhe në përputhshmëri më të lartë. Ndërkohë prioritetet qeveritare si 'Zgjidhja e çështjes së tokave bujqësore të fragmentuara', 'Zhbllokimi i fondit të privatizimit dhe përdorimi i mjeteve për zhvillim' dhe 'Qeverisje e mirë dhe performancë e kënaqshme e korporatave me aksione shtetërore', janë vlerësuar me shkallën më të ulët të përputhshmërisë.

MATRICA 2: INDUSTRIË KONKURRUESE – KOMUNA E PRISHTINËS

	Lehtësimi e qasjes në financa për ndërmarrjet kosovare	Rrjetëzimi dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të grupuara	Kalimi i NVM-ve në aktivite me vlerë më të lartë të shtuar	Rritja e nivelit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) dhe atyre të diasporës	Zgjidhja e çështjes së tokave bujqësore të fragmentuara	Zhbllokimi i fondit të privatizimit dhe përdorimi i mjeteve për zhvillim	Qeverisje e mirë dhe performancë e kënaqshme e korporatave me aksione shtetërore
Qeveria							
Komuna							
Nën-kontraktim i shërbimeve (outsourcing) BPO	6	7	8	9	1	1	1

* VLËRËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)

1 2 3 4 5 6 7 8 9

2.3 Infrastruktura

Ndërsa sa i përket vlerësimeve lidhur me infrastrukturën, si prioritet Komunal është vendosur 'Finalizimi i rrjetit rural dhe urban'. Ky prioritet Komunal, siç mund të shihet në Matricën 3, ka përputhshmëri të ulët me katër prioritetet e para qeveritare lidhur me infrastrukturën: gjegjësisht 'Rritja e kapacitetit vendor të prodhimit të energjisë elektrike nga linjiti dhe burimet e ripërtëritshme', 'Investimi në masa të efijencës për konsumin e energjisë', 'Përfundimi i akteve kryesore ndërkombëtare dhe rajonale rrugore si dhe ndërkombëtare hekurudhore', si dhe 'Rritja e përdorimit të teknologjisë informative në operimet e bizneseve, shkollave dhe institucioneve publike'. Ndër-

kohë, prioritetet qeveritare si 'Përmirësimi i infrastrukturës mbështetëse për prodhimtarinë bujqësore dhe 'Menaxhimi më i qëndrueshëm i mbeturinave' janë konsideruar me rëndësi të madhe edhe për komunën e Prishtinës.

Prioriteti i dytë Komunal sa i përket infrastrukturës është vendosur 'Finalizimi i rrjetit të ujërave të zeza'. Ky prioritet Komunal, është vlerësuar me përputhshmëri të ulët me gjashtë nga shtatë prioritetet qeveritare. Përpos prioritetit qeveritar 'Menaxhimi më i qëndrueshëm i mbeturinave', i cili është vlerësuar i një rëndësie të madhe.

MATRICA 3: INFRASTRUKTURA – KOMUNA E PRISHTINËS

	Qeveria	Rritja e kapacitetit vendor të prodhimit të energjisë elektrike nga linjiti dhe burimet e ripërtëritshme	Investimi në masa të efijencës për konsumin e energjisë	Përfundimi i akteve kryesore ndërkombëtare dhe rajonale rrugore si dhe linja ndërkombëtare hekurudhore	Rritja e përdorimit të teknologjisë informative në operimet e bizneseve, shkollave dhe institucioneve publike	Përmirësimi i infrastrukturës mbështetëse për prodhimtarinë bujqësore	Racionalizimi i përdorimit të ujit dhe rritja e kapaciteteve prodhuese dhe shpërndarëse	Sigurimi i përdorimit të qëndrueshëm të pyjeve të Kosovës	Menaxhimi më i qëndrueshëm i mbeturinave
Finalizimi i rrjetit rural dhe urban	1	1	1	1	9	9	3	9	
Finalizimi i rrjetit të ujërave të zeza	1	1	1	1	1	1	1	7	
Finalizimi i ndriçimit publik në zonat rurale dhe urbane	1	9	1	1	1	1	1	1	
Menaxhimi i mbeturinave	1	7	1	1	1	1	1	9	



VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)



2.3 Bujqësia

Së fundmi, vlerësime të përputhjes së prioriteteve qendrore me ato Komunale janë bërë edhe në fushën e bujqësisë. Prioritetet e parë Komunal në fushën e bujqësisë është vlerësuar të jetë 'Fondi Zhvillimor Rural'. Ky prioritet Komunal, siç mund të shihet edhe në Matricën 4 është vlerësuar të ketë rëndësi nën mesatare në raport me të gjitha prioritetet qeveritare në fushën e bujqësisë. Nga të gjitha prioritetet qeveritare, me e shkallën më të lartë relative të përputhshmërisë është vlerësuar 'Përgatitja dhe financimi i projektit të rregullimit të tokës dhe integrimi në projektet e zhvillimit rural', me gjegjësisht pesë pikë.

Prioriteti i vetëm qeveritar që është konsideruar në përputhshmëri të lartë me prioritetin e tretë Komunal 'Ndërtimi i rrjetit të ujitjes' dhe në fakt me gjitha prioritetet Komunale bujqësore, është 'Zgjerimi i mbulueshmërisë së sistemit të ujitjes së paku në 40përqind të tokës së punueshme deri në vitin 2021', siç paraqet Matrica 4.

MATRICA 4: BUJQËSIA – KOMUNA E PRISHTINËS

	Qeveria	Zgjerimi i mbulueshmërisë së sistemit të ujitjes së paku në 40% të tokës së punueshme deri në 2021	Krijimi i platformës së Sistemit të Integruar Informativ Bujqësor për ta rritur konkurrueshmërinë	Zgjidhja e çështjes së tokave bujqësore të fragmentuara	Rritja e numrit të objekteve të deponimit dhe magazinimit përmes Partneriteteve Publiko-Private	Rritja e numrit të njësive të testimit laboratorik për cilësinë e prodhimit privat të farërave	Financimi i projektit të rregullimit të tokës dhe integrimi në projektet e zhvillimit rural	Reforma strukturore me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për rritjen e prodhimtarisë bujqësore	Krijimi i ngastrave në formë të rregullt gjeometrike dhe realizimi i projektit të Identifikimit të Parcelave (LPIS)	Formimi i rrjetit të rrugëve fushore dhe eliminimi i servitutit sezonal – qasja në pronë përmes pronës së dikujt tjetër
Fondi zhvillimor rural	3	1	3	2	1	5	1	3	3	
Tregjet mobile të fermerëve	1	1	1	1	1	1	1	1	1	
Ndërtimi i rrjetit të ujitjes	9	1	1	1	1	1	1	1	1	



VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)





Në fund, zyrtarët Komunalë janë deklaruar për bashkëpunimin në mes të qeverisjes qendrore me atë lokale. Sipas zyrtarëve të Komunës së Prishtinës, ata nuk janë konsultuar me qeverinë qendrore lidhur me përpilimin e prioriteteve Komonale. Gjithnjë sipas tyre, komunikimi me nivelin qendror është totalisht i politizuar, dhe në këtë mënyrë pothuajse i pamundur për shkak të diferencave partiake. Bashkëpunimi me qeverinë qendrore, në rrethana të normalitetit do të ishte i një rëndësie të jashtëzakonshme për Komunën, pasi që ka hapësirë për përmirësim të bashkëpunimit në të gjithë sektorët.



3. KOMUNA E PODUJEVËS

Prioritetet e Komunës së Podujevës, që ndryshe quhen edhe qëllimet strategjike, janë:

1. Zhvillimi i qëndrueshëm, ku përfshihen

- 1.1. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik përmes stimulimit të sektorit privat dhe krijimit të mjedisit të përshtatshëm për zhvillim të biznesit dhe rritjes së investimeve dhe punësimit;
- 1.2. Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë duke ofruar kushte dhe infrastrukturë të përshtatshme, ngritje të kapaciteteve të fermerëve për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore me qëllim të krijimit të vendeve të reja të punës;
- 1.3. Sigurimi i cilësisë në arsim, ngritja profesionale e personelit arsimor, si dhe avancimi i infrastrukturës fizike për mësimdhënie dhe mësim nxënie;
- 1.4. Promovimi i aktiviteteve kulturore dhe sportive në funksion të zhvillimit të turizmit;
- 1.5. Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës dhe mbrojtja e mjedisit dhe e tokave bujqësore; dhe

2. Mirëqenia e qytetarëve, ku përfshihen

- 2.1 Përmirësimi dhe ofrimi efikas i shërbimeve shëndetësore dhe sociale për qytetarët e komunës dhe

- 2.2 Përmirësimi i dhe ofrimi efikas i shërbimeve Komunale administrative për nevoja të qytetarëve.

Nga intervista e zhvilluar me zyrtarët e komunës së Podujevës doli se këto prioritetet janë përcaktuar duke u bazuar kryesisht në bisedimet dhe konsultimet me ekspertë të fushave si ekonomia, bujqësia, arsimit; me zyrtarë të bizneseve lokale; fermerë të komunës dhe fshatrave dhe palë të tjera të interesit. Po ashtu, janë konsultuar dokumente relevante si Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti i Komunës, Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Podujevës 2015-2017 si dhe strategjitë e mëparshme zhvillimore të komunës.

Këto prioritetet në fjalë janë të ankoruara në Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal (SZHEL) të hartuar nga Komuna e Podujevës për vitet 2016-2018 dhe sipas zyrtarëve të komunës kjo strategji shërben si dokument strategjik dhe udhërrëfyes për punën e përditshme në komunë nga të gjitha drejtoritë.

Zyrtarët e komunës kanë konsideruar se kjo strategji është plotësisht e realizueshme, pasi që është shumë konkrete dhe i merr parasysh specifikat, nevojat dhe vështirësitë e komunës. Megjithatë, marrë parasysh mjetet që i ka Komuna në dispozicion për periudhën e paraparë ata mendojnë që afërsisht 80 përqind e strategjisë dhe prioritetëve dhe projekteve të saj do të arrijnë të realizohen. Kjo duke u bazuar në mjetet e alokuara nga granti qeveritar në kuadër të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve. Por, me llogaritjen e të hyrave vetanake dhe donacioneve zyrtarët e komunës kanë deklaruar se mund të arrihet buxhetimi i plotë i këtyre prioritetëve.

3.1 Kapitali njerëzor

Në intervistën e zhvilluar, zyrtarët e komunës kanë renditur prioritetet Komunale për zhvillim të kapitalit njerëzor sipas rëndësisë dhe kanë vlerësuar se sa përputhen prioritetet e nivelit qendror me këto prioritetet Komunale në një shkallë prej 1 deri në 9. Prioriteti i parë i komunës së Podujevës në këtë lëmi është 'Përmirësimi i infrastrukturës fizike shkollore dhe jashtë shkollore në zonat rurale'. Në raport me këtë prioritet Komunal, prioriteti qeveritar 'Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucionet parashkollore', është vlerësuar i një rëndësie relativisht të madhe të përputhshmërisë. Përkundrazi, tri prioritetet qeveritare të radhës

'Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm'; 'Përmirësimin e ndërlidhjes ndërmjet shkathtësive të fituara në arsim dhe kërkesave të tregut të punës'; dhe 'Forcimi i funksioneve të provimit, inspektimit dhe akreditimit në sistemin arsimor' janë vlerësuar me shkallë nën-mesatare, në relacion me prioritetin e parë komunës. Ndërsa prioritetet 'Ulja e nivelit të punësimit joformal' dhe 'Angazhimi afatshkurtër i ekspertëve dhe studentëve të diasporës' kanë marrë vlerësimin më të ulët për nga përputhshmëria, përkatësisht me nga një pikë (siç mund të shihet në Matricën 5).

MATRICA 5: KAPITALI NJERËZOR – KOMUNA E PODUJEVËS

	Komuna	Qeveria	Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucione parashkollore	Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm	Përmirësimi i ndërlidhjes ndërmjet shkathtësive të fituara në arsim dhe kërkesave të tregut të punës	Forcimi i funksioneve të provimit, inspektimit dhe akreditimit në sistemin arsimor	Përmirësimi i planifikimit të shpenzimeve në sistemin e arsimit	Ulja e nivelit të punësimit joformal	Angazhimi afatshkurtër i ekspertëve dhe studentëve të diasporës
Përmirësimi i infrastrukturës fizike shkollore dhe jashtë shkollore në zonat rurale	7	5	5	4	4	6	1	1	
Pajisja me kabinete të shkollave të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, me numër të madh të nxënësve	6	7	6	4	5	1	1		
Ngritja e rolit të komunitetit lokal dhe atij të biznesit në vendimarrjen e shkollës, kryesisht në përshtatjen e drejtimeve profesionale me nevojat e tregut	7	7	1	7	4	5	6		
Ngritja profesionale e vazhdueshme për nivelin e ulët dhe të mesëm të mësimdhënësve në fushën pedagogjike dhe metodologjike si dhe aplikimin e TI-së në mësimdhënie	5	9	7	7	5	6	6		
Sigurimi i transportit për të gjithë nxënësit e nivelit obligator shkollore që banojnë 4 km larg shkollës	4	4	5	4	7	6	5		
Krijimi i kushteve për gjithëpërfshirjen aktive të fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin arsimor	8	7	6	4	5	4	3		
Riaftësimi i personave që janë të papunë për tregun e punës	8	7	8	6	7	5	5		
Hapja e drejtimeve bazuar në analizën e nevojave të tregut në shkollat profesionale	8	8	8	7	7	6	5		
Punësimi i dy ekspertëve të mjedrës dhe pemëve të imëta për ofrimin e asistencës gjithë fermerëve të komunës në mbjelljen, trajtimin, mbrojtjen, kultivimin dhe vjeljen e tyre	2	2	3	3	3	4	7		



VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSË MË TË ULËT, 9 RËNDËSË MË TË LARTË)



3.2 Industritë konkurruese

Vlerësime të këtij lloji janë bërë edhe lidhur me industritë konkurruese. Këtu, prioriteti i parë sipas renditjes është 'Përmirësimi i klimës së biznesit dhe mbështetja e tyre (ofrimi i këshillave profesionale për bizneset; Lehtësira në taksat dhe tarifat Komunale për bizneset që gjenerojnë punësim; Ndhimesë dhe asistim për bizneset në aplikim për fonde)', me të cilin janë vlerësuar shtatë nga prioritetet qeveritare për industritë konkurruese. 'Lehtësimi e qasjes në financa për ndërmarrjet kosovare', si prioritet i parë i nivelit qendror, nuk është vlerësuar të jetë i një rëndësie të madhe, në raport me këtë prioritet Komunal, pasi që vlerësohet se Komuna ka kompetenca të pakta në këtë drejtim. Prioritetet qendrore dy, tre dhe pesë 'Rrjetëzimi dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të grupuara', 'Kalimi i NVM-ve në aktivitetet

me vlerë më të lartë të shtuar' dhe 'Zgjidhja e çështjes së tokave bujqësore të fragmentuara', po ashtu janë vlerësuar të një rëndësie mesatare krahas prioritetit të parë Komunal. Këto tri prioritate qeveritare konsiderohen si shumë të rëndësishme për zhvillimin e më tutjeshëm të komunës së Podujevës, mirëpo në këto fusha janë ende në hapat fillestar. Ndërsa, prioriteti qeveritar me përputhshmëri më të lartë krahas prioritetit të parë Komunal është 'Rritja e nivelit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) dhe atyre të diasporës', pasi që Komuna e Podujevës e konsideron një ndër faktorët kyç për zhvillimin ekonomik të komunës dhe për këtë edhe ka identifikuar si prioritet ngritjen dhe funksionalizimin e zyrës për promovim dhe tërheqjen e investimeve gjatë vitit 2016.

MATRICA 6: INDUSTRIË KONKURRUESE – KOMUNA E PODUJEVËS

Komuna	Qeveria	Lehtësimi e qasjes në financa për ndërmarrjet kosovare	Rrjetëzimi dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të grupuara	Kalimi i NVM-ve në aktivitetet me vlerë më të lartë të shtuar	Rritja e nivelit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) dhe atyre të diasporës	Zgjidhja e çështjes së tokave bujqësore të fragmentuara	Zhbllokimi i fondit të privatizimit dhe përdorimi i mjeteve për zhvillim	Qeverisje e mirë dhe performancë e kënaqshme e korporatave me aksione shtetërore
Përmirësimi i klimës së biznesit dhe mbështetja e tyre	5	6	6	9	6	2	2	
Inventarizimi i pronës Komunale që mund të jepet për nevoja ekonomike	4	7	6	9	9	2	4	
Krijimi dhe funksionalizimi i inkubatorit të biznesit	5	7	5	7	2	4	6	
Ngritja e kapaciteteve Komunale dhe përfundimi i studimit të fizibilitetit për projektet PPP	7	4	7	7	5	7	6	
Ngritja e Zyrës për promovim dhe tërheqjen e investimeve	2	3	6	9	5	3	5	
Themelimi i Zyrës për Diasporë	3	3	5	9	7	2	5	
Funksionalizimi i zonës industriale	4	8	7	9	8	4	8	
Punësimi i dy ekspertëve të mjedris dhe pemëve të imëta për ofrimin e asistencës gjithë fermerëve të komunës në mbjelljen, trajtimin, mbrojtjen, kultivimin dhe vjeljen e tyre	2	2	3	4	3	2	2	



VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)



3.3 Infrastruktura

Në kuadër të vlerësimeve lidhur me infrastrukturën e komunës, prioriteti i renditur më së larti në komunën e Podujevës është 'Hartimi i hartave zonale për tërë territorin e komunës, deri në vitin 2018'. Prioriteti i parë qendror lidhur me infrastrukturën është 'Rritja e kapacitetit vendor të prodhimit të energjisë elektrike nga linjiti dhe burimet e ripërtëritshme', i cili është vlerësuar jo-relevant, njëjtë si prioriteti i katërt 'Rritja e përdorimit të teknologjisë informative në

operimet e bizneseve, shkollave dhe institucioneve publike', krahas këtij prioriteti Komunal. 'Investimi në masa të efijencës për konsumin e energjisë', si prioritet i dytë qeveritar, është konsideruar po ashtu jo aq relevant, në raport me prioritetin Komunal në fjalë. Prioriteti 'Përfundimi i akseve kryesore ndërkombëtare dhe rajonale rrugore si dhe linja ndërkombëtare hekurudhore', është vlerësuar vetëm mesatarisht i rëndësishëm.

MATRICA 7: INFRASTRUKTURA – KOMUNA E PODUJEVËS

	Komuna	Qeveria	Rritja e kapacitetit vendor të prodhimit të energjisë elektrike nga linjiti dhe burimet e ripërtëritshme	Investimi në masa të efijencës për konsumin e energjisë	Përfundimi i akseve kryesore ndërkombëtare dhe rajonale rrugore si dhe linja ndërkombëtare hekurudhore	Rritja e përdorimit të teknologjisë informative në operimet e bizneseve, shkollave dhe institucioneve publike	Përmirësimi i infrastrukturës mbështetëse për prodhimtarinë bujqësore	Racionalizimi i përdorimit të ujit dhe rritja e kapaciteteve prodhuese dhe shpërndarëse	Sigurimi i përdorimit të qëndrueshëm të pyjeve të Kosovës	Menaxhimi më i qëndrueshëm i mbeturinave
Hartimi i hartave zonale për tërë territorin e komunës	2	5	6	2	8	8	7	8		
Hartimi i planeve rregulluese detale për zonën urbane	2	1	6	2	5	6	4	7		
Zhvillimi i kapaciteteve të personelit teknik/profesional për përdorimin e sistemeve të TI	2	2	3	9	6	2	2	2		
Eliminimi i tërësishëm i deponive ilegale	2	2	3	2	5	5	4	9		
Krijimi i sistemit dhe bazës së të dhënave për menaxhim të projekteve infrastrukturore	4	5	3	8	5	3	3	3		
Rregullimi i shtretërve të lumenjve në funksion të mbrojtjes nga vërshimet dhe tokës bujqësore	4	1	5	6	7	5	4	5		
Rikonstruktimi i rrugëve së bashku me infrastrukturën nëntokësore, dhe krijimi i sheshit në qendër	2	2	5	4	2	2	2	3		
Rindërtimi i 10 zonave kadastrale dhe bartja e pronave tek qytetarët	2	2	3	5	4	2	2	2		
Ndërtimi i qendrës rekreative sportive në Battlavë dhe mirëmbajtja dhe rritja e sipërfaqeve gjelbëruese në qytet	2	2	3	4	1	2	2	2		
Funksionalizimi i ujësjellësit në vendet në të cilat ka rrjet të ujësjellësit por që nuk janë të kycura	2	2	2	2	2	7	4	4		



VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)



3.4 Bujqësia

Së fundmi, vlerësime të përputhjes së prioriteteve qendrore me ato Komunale janë kërkuar edhe në fushën e bujqësisë. Këtu, prioritetet me rëndësi më të madhe në komunën e Podujevës është 'Promovimi i Podujevës si liderë e pemëve të imta, shpallja e mjedrës produkt strategjik si dhe organizimi i përvjetshëm i ditës së mjedrës'. Prioritetet qeveritare që janë vlerësuar të një përputhshmërie të lartë krahas këtij prioriteti Komunal janë 'Krijimi

i platformës informative të Sistemit të Integruar Informativ Bujqësor për ta rritur konkurrueshmërinë në sektorin e bujqësisë' dhe 'Rritja e numrit të objekteve të deponimit dhe magazinimit në rajonet kryesore të Kosovës përmes Partneriteteve Publiko-Private', të dyja këto të vlerësuara me nga tetë pikë.

MATRICA 8: BUJQËSIA – KOMUNA E PODUJEVËS

	Qeveria	Komuna	Zgjerimi i mbulueshmërisë së sistemit të ujitjes së paku në 40% të tokës së punueshme deri në 2021	Krijimi i platformës së Sistemit të Integruar Informativ Bujqësor për ta rritur konkurrueshmërinë	Zgjidhja e çështjes së tokave bujqësore të fragmentuara	Rritja e numrit të objekteve të deponimit dhe magazinimit përmes Partneriteteve Publiko-Private	Rritja e numrit të njësive të testimit laboratorik për cilësinë e prodhimit privat të farërave	Financimi i projektit të rregullimit të tokës dhe integrimi në projektet e zhvillimit rural	Reforma strukturore me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për rritjen e prodhimtarisë bujqësore	Krijimi i ngastrave në formë të rregullt gjeometrike dhe realizimi i projektit të Identifikimit të Parcelave (LPIS)	Formimi i rrjetit të rrugëve fushore dhe eliminimi i servitutit sezonal – qasja në pronë përmes pronës së dikujt tjetër
Promovimi i Podujevës si liderë e pemëve të imta, shpallja e mjedrës produkt strategjik	7	8	6	8	8	8	8	6	7	7	
Kategorizimi dhe klasifikimi i bonitetit të tokës bujqësore	5	8	6	5	5	5	5	7	6	6	
Funksionalizimi i pikave grumbulluese për pemë dhe perime	2	4	2	8	5	4	6	3	6		
Ngritja e pikës grumbulluese të qumështit	2	3	3	8	7	2	8	2	6		
Shtimi i numrit të serave për 30% deri në 2018	7	4	2	7	4	4	4	4	4		
Mbështetja e fermerëve në ngritjen e sistemit të ujitjes	8	2	6	5	7	6	5	5	4		
Ndihmesë në ngritjen profesionale të bletarëve si dhe subvencionimi i koshereve të bletëve	2	6	2	2	5	2	3	2	2		
Mbështetja e blegtorëve në rritjen e fondit të bagëtisë deri në 10% nga numri aktual, përkrahje në pajisje për mjelje dhe koncentrat ushqyes	6	6	5	5	7	7	6	5	3		
Mbështetja e fermerëve në rritjen e sipërfaqes së pemishteve në 10%	8	6	6	8	7	6	7	7	6		
Krijimi i sistemit mbikëqyrës elektronik i procesit të dhënies së lejes dhe ekzekutimit të prerjes së pyjeve	2	2	2	2	2	4	2	2	5		




VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)





Në përfundim, zyrtarët e komunës së Podujevës janë shprehur në lidhje me bashkëpunimin në mes nivelit lokal dhe qendror gjatë përpilimit të prioriteteve Komunale. Kështu, zyrtarët kanë deklaruar se janë konsultuar me zyrtarët e nivelit qendror deri në një masë, dhe po ashtu i kanë shqyrtuar edhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, megjithatë hartimin e prioriteteve e kanë bërë kryesisht duke u bazuar në konsultime brenda komunës dhe me palë të interesit. Në çështjet lidhur me përpilimin e buxhetit dhe vendosjen e kufijve buxhetor, bashkëpunimi shihet si me i frytshëm. Po ashtu, kooperimi me nivelin qendror konsiderohet përgjithësisht i rregullt; drejtoritë specifike të komunës janë në kontakt të rregullt me ministritë përkatëse, mirëpo vlerësohet se bashkëpunimi duhet të jetë më efektiv në aspektin e këshill-dhënies dhe ekzekutimit të çështjeve të përbashkëta. Për më tepër, konsiderohet shumë e rëndësishme nga zyrtarët e komunës që të mbahen takime të rregullta e efektive të Ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me drejtorët për bujqësi të të gjitha Komunave për bashkërendimin e prioriteteve, ashtu siç sipas tij i mban Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, një herë në muaj.



4. KOMUNA E FUSHË KOSOVËS

Komuna e Fushë Kosovës i ka pesë prioritete të përgjithshme, si në vijim:

1. **Zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme për bizneset dhe qytetarët,**
2. **Modernizimin e administratës,**
3. **Zhvillimin e infrastrukturës së arsimit,**
4. **Ngritjen e kapaciteteve bujqësore, dhe**
5. **Përmirësimin dhe mbrojtjen e mjedisit.**

Këto synime të komunës janë të inkuorporuara në Strategjinë Komunale për Zhvillim Ekonomik 2016-2020, e cila është hartuar nga Grupi Punues Komunal i caktuar nga Kryetari i Komunës. Realizueshmëria e këtij dokumenti strategjik për një periudhë pesë-vjeçare mbërrin kosto totale të implementimit prej afër 27 milion euro.

Prioritetet e komunës së Fushë Kosovës janë përcaktuar duke u bazuar në bisedimet dhe konsultimet me ekspertë të fushave si ekonomia, bujqësia, arsimit. Këto prioritete janë inkuorporuar në Strategjinë Komunale për Zhvillim Ekonomik 2016-2020. Projekt – Strategjia Komunale për Zhvillim Ekonomik 2016-2020, është punuar nga Grupi Punues Komunal i caktuar nga Kryetari i Komunës. Me këtë dokument është paraparë realizimi i projekteve kapitale: për administratën dhe modernizimin e saj, infrastrukturën lokale, mbrojtjen e mjedisit, energjinë, arsimin, shëndetësinë, mirëqenien sociale e strehimit, kulturën dhe sportin.

4.1 Kapitali njerëzor

Ne komunën e Fushë Kosovës në sektorin e kapitalit njerëzor janë të renditura këto prioritete 1) Përmirësimi i kushteve në institucionet arsimore me infrastrukturë përcjellëse për 25përqind, deri në vitin 2019, 2) Përfshirja e numrit të fëmijëve në institucionet e arsimit para fillor për 30përqind deri në vitin 2019, 3) Përfshirja e numrit të fëmijëve në institucionet e arsimit para fillor për 30përqind deri në vitin 2019, 4) Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve në arsim, shëndetësi dhe shërbime tjera publike/Komunale, 5) Ndërtimi i objekteve dhe hapësirave të reja të infrastrukturës sociale si dhe përmirësimi i atyre ekzistuese.

Prioritetet qeveritare 1) Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucione parashkollore, 2) Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm, dhe 5) Përmirësimi i planifikimit të shpenzimeve në sistemin e arsimit, janë vlerësuar më të rëndësishme në krahasim me prioritetet e tjera

qeveritare brenda kapitalit njerëzor për prioritetet Komunale një, dy dhe katër, përkatësisht 1) Përmirësimi i kushteve në institucionet arsimore me infrastrukturë përcjellëse për 25 përqind, deri në vitin 2019, 2) Përfshirja e numrit të fëmijëve në institucionet e arsimit para fillor për 30 përqind deri në vitin 2019, dhe 4) Ndërtimi i objekteve dhe hapësirave të reja të infrastrukturës sociale si dhe përmirësimi i atyre ekzistuese.

Ndërsa, prioritetet qeveritare me më së paku rëndësi për prioritetet e paracaktuara Komunale për komunën e Fushë Kosovës janë prioritetet gjashtë dhe shtatë, ndryshe, 6) Ulja e nivelit të punësimit joformal, dhe 7) Angazhimi afatshkurtër i ekspertëve dhe studentëve të diasporës. Ndërkaq, prioriteti i gjashtë qendror është vlerësuar të jetë mjaft relevant përballë secilit prioritet Komunal në komunën e Fushë Kosovës; kjo për shkak të ndërlidhjes së secilit projekt me ndarjen buxhetore brenda komunës.

MATRICA 9: KAPITALI NJERËZOR – KOMUNA E FUSHË KOSOVËS

	Komuna	Qeveria	Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucione parashkollore	Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm	Përmirësimi i ndërlidhjes ndërmjet shkathësive të fituara në arsim dhe kërkesave të tregut të punës	Forcimi i funksioneve të provimit, inspektimit dhe akreditimit në sistemin arsimor	Përmirësimi i planifikimit të shpenzimeve në sistemin e arsimit	Ulja e nivelit të punësimit joformal	Angazhimi afatshkurtër i ekspertëve dhe studentëve të diasporës
Përmirësimi i kushteve në institucionet arsimore me infrastrukturë përcjellëse për 25përqind, deri në vitin 2019	6	8	3	4	6	1	1		
Përfshirja e numrit të fëmijëve në institucionet e arsimit para fillor për 30 përqind deri në vitin 2019	6	7	3	4	6	1	1		
Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve në arsim, shëndetësi dhe shërbimet tjera publike / Komunale	5	5	4	4	6	1	2		
Ndërtimi i objekteve dhe hapësirave të reja të infrastrukturës sociale si dhe përmirësimi i atyre ekzistuese	6	8	5	3	8	2	1		



VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)



4.2 Industritë konkurruese

Në sektorin e industrive konkurruese për komunën e Fushë Kosovës janë renditur këto prioritetet 1) Rritja e nivelit të shërbimeve administrative për biznese (reduktimi i procedurave), rritja e numrit të bizneseve deri në 15përqind brenda vitit 2018, 2) Zhvillimi i NVM-ve, 3) Funkcionalizimi i brezit të biznesit, 4) Funkcionalizimi i pikave dhe zonës me potencial turistik, dhe 5) Mbrojtja dhe kultivimi i tokës bujqësore.

Intervistat e zhvilluara tregojnë se në sektorin e industrive konkurruese ka ndërlidhje relativisht të mirë mes prioriteteve qendrore dhe atyre lokale. Sipas vlerësimeve të zyrtarëve të komunës së Fushë Kosovës, 'Lehtësimi i qasjes në financa për ndërmarrjet kosovare' si prioritet qendror megjithatë nuk ka përputhshmëri të lartë në raport me prioritetet Komunale të renditura në matricën e prioriteteve, pasi që prioriteti qendror në fjalë nuk bie në kompetenca të komunës. Megjithatë, ky prioritet qendror vlerësohet të jetë i rëndësishëm pasi që ndikon në zhvillimin e industrive konkurruese në vend, rrjedhimisht edhe në nivel lokal.

Për prioritetin e dytë të komunës së Fushë Kosovës në sektorin e industrive konkurruese, përkatësisht zhvillimi i NVM-ve,

prioritetet qeveritare, që janë më shumë në përputhshmëri, janë: Rrjetëzimi dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të grupuara, Kalimi i NVM-ve në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar, si dhe Rritja e nivelit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) dhe atyre të diasporës. Vlerësim i ngjashëm është bërë edhe për prioritetet Komunale të radhës, Funkcionalizimi i brezit të biznesit, Rrjetëzimi dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të grupuara, Kalimi i NVM-ve në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar, si dhe Rritja e nivelit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) dhe atyre të diasporës.

'Mbrojtja dhe kultivimi i tokës bujqësore' është vlerësuar të ketë ndërlidhje më të lartë me prioritetet qeveritare të ankoruara në SKZH. Përveç prioriteteve qeveritare 'Zhbllokimi i fondit të privatizimit dhe përdorimi i mjeteve për zhvillim' dhe 'Qeverisje e mirë dhe performancë e kënaqshme e korporatave me aksione shtetërore', të cilat nuk janë pothuajse aspak relevante për prioritetin e komunës, të gjitha prioritetet e tjera qeveritare të renditura në matricë kanë një përputhshmëri relativisht të lartë.

MATRICA 10: INDUSTRIË KONKURRUESE – KOMUNA E FUSHË KOSOVËS

Komuna	Qeveria	Lehtësimi i qasjes në financa për ndërmarrjet kosovare	Rrjetëzimi dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të grupuara	Kalimi i NVM-ve në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar	Rritja e nivelit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) dhe atyre të diasporës	Zgjidhja e çështjes së tokave bujqësore të fragmentuara	Zhbllokimi i fondit të privatizimit dhe përdorimi i mjeteve për zhvillim	Qeverisje e mirë dhe performancë e kënaqshme e korporatave me aksione shtetërore
Rritja e nivelit të shërbimeve administrative për biznese (reduktimi i procedurave), rritja e numrit të bizneseve deri në 15përqind brenda vitit 2018		1	4	5	6	5	5	2
Zhvillimi i NVM		2	7	6	7	5	4	2
Funksionalizimi i brezit të biznesit		3	5	6	5	4	4	1
Funksionalizimi i pikave dhe zonës me potencial turistik		2	1	2	3	2	1	2
Mbrojtja dhe kultivimi i tokës bujqësore		4	5	5	1	7	2	1



VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)



4.3 Infrastruktura

Prioritetet e komunës së Fushë Kosovës për sektorin e infrastrukturës të renditura në matricën e vlerësimit janë: 1) Ndërtimi i rrugëve të reja si dhe përmirësimi i atyre ekzistuese në rrjetin Komunal të trafikut automobilistik e hekurudhor, 2) Përmirësimi i lidhjeve të transportit publik në tërë komunën 3) Shtimi i kapaciteteve prodhuese të ujit në të gjithë fshatrat dhe përmirësimi i rrjetit të vjetruar të ujësjellësit për 50 përqind për vitet 2016-2020, 4) Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të kanalizimit/ zgjerimi i rrjetit të kanalizimit për 40 përqind deri në vitin 2019, 5) Përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit dhe shtimi i kapaciteteve prodhuese të ujit, dhe 6) Përmirësimi i rrjetit për furnizim me energji dhe rrjetit të telefonisë e internetit.

Prioritetet qeveritare të cilat janë konsideruar dhe vlerësuar si më relevante për shumicën e prioritetëve të komunës së Fushë Kosovës janë: 'Përmirësimi i infrastrukturës mbështetëse për

prodhimtarinë bujqësore' dhe 'Racionalizimi i përdorimit të ujit dhe rritja e kapaciteteve prodhuese dhe shpërndarëse'.

Prioriteti 'Racionalizimi i përdorimit të ujit dhe rritja e kapaciteteve prodhuese dhe shpërndarëse' është vlerësuar me relativisht i rëndësishëm në raport me prioritetin e dytë të komunës, përkatësisht 'Përmirësimi i lidhjeve të transportit publik në tërë komunën'. Pastaj, i njëjti prioritet qeveritar është vlerësuar me rëndësi mjaft të madhe në raport me prioritetin 'Shtimi i kapaciteteve prodhuese të ujit në të gjithë fshatrat dhe përmirësimi i rrjetit të vjetruar të ujësjellësit për 50përqind për vitet 2016-2020', kurse tutje me gjashtë dhe shtatë pikë është vlerësuar ndërlidhja e këtij prioriteti qeveritar në raport me prioritetet Komunale 'Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të kanalizimit/ zgjerimi i rrjetit të kanalizimit për 40 përqind deri në vitin 2019', dhe 'Përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit dhe shtimi i kapaciteteve prodhuese të ujit'.

MATRICA 11: INFRASTRUKTURA – KOMUNA E FUSHË KOSOVËS

	Komuna	Qeveria	Rritja e kapacitetit vendor të prodhimit të energjisë elektrike nga linjiti dhe burimet e ripërtëritshme	Investimi në masa të efijencës për konsumin e energjisë	Përfundimi i akteve kryesore ndërkombëtare dhe rajonale rrugore si dhe linja ndërkombëtare hekurudhore	Rritja e përdorimit të teknologjisë informativë në operimet e bizneseve, shkollave dhe institucioneve publike	Përmirësimi i infrastrukturës mbështetëse për prodhimtarinë bujqësore	Racionalizimi i përdorimit të ujit dhe rritja e kapaciteteve prodhuese dhe shpërndarëse	Sigurimi i përdorimit të qëndrueshëm të pyjeve të Kosovës	Menaxhimi më i qëndrueshëm i mbeturinave
Ndërtimi i rrugëve të reja si dhe përmirësimi i atyre ekzistuese në rrjetin Komunal të trafikut automobilistik e hekurudhor	1	1	3	1	1	1	1	1	1	1
Përmirësimi i lidhjeve të transportit publik në tërë komunën.	1	1	2	1	4	6	1	1	1	
Shtimi i kapaciteteve prodhuese të ujit në të gjithë fshatrat dhe përmirësimi i rrjetit të vjetruar të ujësjellësit për 50 përqind	1	1	1	1	5	8	1	5		
Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza dhe përmirësimi i rrjetit të kanalizimit/ zgjerimi i rrjetit të kanalizimit për 40 përqind	1	1	1	1	3	6	1	6		
Përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit dhe shtimi i kapaciteteve prodhuese të ujit	1	1	1	1	6	7	1	1		
Përmirësimi i rrjetit për furnizim me energji elektrike dhe rrjetit të telefonisë e internetit	6	7	1	1	1	1	1	1	1	



VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)



4.4 Bujqësia

Në sektorin e bujqësisë për komunën e Fushë Kosovës janë renditur këto prioritete: 1) Përmirësimi i kapaciteteve prodhuese të bujqësisë (Rritja e fondit të bagëtisë për 30përqind deri në vitin 2020, Rritja e prodhimtarisë bletare deri në vitin 2020, rritja e prodhimtarisë së pemëtarisë për 20përqind deri në vitin 2020, dhe rritja e prodhimtarisë perimore për 20përqind deri në vitin 2020), 2) Mbrojtja dhe kultivimi i tokës bujqësore, 3) Shtimi i prodhimit bujqësor dhe ngritja e agrobizneseve, dhe 4) Ngritja e impianteve për përpunimin e prodhimeve bujqësore.

Rëndësia e prioriteteve qeveritare për sektorin e bujqësisë krahas atyre Komunale është vlerësuar të jetë në shkallë mesatare për shumicën e prioriteteve të renditura në matricë. Kështu, rëndësia e prioritetit qeveritar ' Zgjerimi i mbu-

lueshmërisë së sistemit të ujitjes së paku 40 përqind të tokës së punueshme deri në vitin 2021' për prioritetet Komunale një, dy dhe tre, është vlerësuar me shkallë pak mbi mesataren.

Nga të gjitha prioritetet qeveritare për sektorin e bujqësisë, prioritetet 'Krijimi i platformës informative të Sistemit të Integruar Informativ Bujqësor për ta rritur konkurrueshmërinë në sektorin e bujqësisë' dhe prioriteti 'Krijimi i ngastrave në formë sa më të rregullt gjeometrike, të përshtatshme për përdorim të lehtë të mekanizmit bujqësorë, si dhe realizimi i projektit të Sistemit të Identifikimit të Parcelave (LIPS)', janë prioritete që nga zyrtarët Komunal të Fushë Kosovës janë vlerësuar si prioritete me më së paku rëndësi krahas prioriteteve të tyre Komunale.

MATRICA 12: BUJQËSIA – KOMUNA E FUSHË KOSOVËS

	Qeveria	Komuna	Zgjerimi i mbulueshmërisë së sistemit të ujitjes së paku në 40% të tokës së punueshme deri në 2021	Krijimi i platformës së Sistemit të Integruar Informativ Bujqësor për ta rritur konkurrueshmërinë	Zgjidhja e çështjes së tokave bujqësore të fragmentuara	Rritja e numrit të objekteve të deponimit dhe magazinimit përmes Partneriteteve Publiko-Private	Rritja e numrit të njësive të testimit laboratorik për cilësinë e prodhimit privat të farërave	Financimi i projektit të rregullimit të tokës dhe integrimi në projektet e zhvillimit rural	Reforma strukturore me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për rritjen e prodhimtarisë bujqësore	Krijimi i ngastrave në formë të rregullt gjeometrike dhe realizimi i projektit të Sistemit të Identifikimit të Parcelave (LIPS)	Formimi i rrjetit të rrugëve fushore dhe eliminimi i servitutit sezonal – qasja në pronë përmes pronës së dikujt tjetër
Përmirësimi i kapaciteteve prodhuese në bujqësi	5	2	4	3	3	2	5	3	5		
Mbrojtja dhe kultivimi i tokës bujqësore	6	1	3	3	3	2	4	3	4		
Shtimi i prodhimit bujqësor dhe ngritja e agrobizneseve	7	2	5	4	3	4	3	2	1		
Ngritja e impianteve për përpunimin e prodhimeve bujqësore	3	1	4	2	3	4	1	2	2		




VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSË MË TË ULËT, 9 RËNDËSË MË TË LARTË)





Në përfundim, zyrtarët e komunës së Fushë Kosovës janë pyetur në lidhje me bashkëpunimin në mes nivelit lokal dhe qendror gjatë përpilimit të prioriteteve Komunale. Zyrtarët e Fushë Kosovës tregojnë se bashkëpunimi me qeverinë qendrore ekziston, mirëpo ka hapësirë për ngritje të këtij bashkëpunimi, kjo përmes takimeve me të shpeshta nga dy palett.



5. KOMUNA E OBILIQIT

Komuna e Obiliqit ka përqendruar aktivitetet e saj për dy vitet e ardhshme në prioritetet e përgjithshme si në vijim:

1. **Zhvillimi i infrastrukturës,**
2. **Zhvillimi i ekonomik dhe**
3. **Përmirësimi i qëndrueshmërisë së ambientit.**

Këto prioritete janë caktuar gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal në 2009 dhe adaptimeve të mëvonshme të këtij plani. Ndryshimet në plan janë manifestuar me përpilimin e Planit të Punës së Kryetarit dhe planifikimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore.

Komuna e Obiliqit ka qenë e obliguar të krijojë një lloj të ri të planifikimit për zhvillim Komunal nga viti 2009, kur është shpallur si zonë me Interes të Veçantë Ekonomik nga Qeveria e Kosovës. Ky ndryshim organizativ ka pasur ndikim të lartë në qeverisjen e komunës dhe delegimin e kompetencave në vendimmarrje mes nivelit qendror dhe lokal. Për më tepër, edhe pse në kuadër të këtij riorganizimi Qeveria është zotuar të merret me zhvillimin e komunës si zonë strategjike për zhvillim kombëtar, duke bërë investime kapitale në energji, transport, dhe mjedis, progresi ka qenë minimal. Në të njëjtën kohë, aktivitetet në kompetencë të komunës mbeten të limituara.

Për më tepër, zyrtarë nga Komuna vlerësojnë se buxheti Komunal nuk është i mjaftueshëm për të realizuar projektet që janë paraparë në Planin Zhvillimor Komunal. Prandaj, Korniza Afatmesme Buxhetore nga viti 2011 ka qenë më i rezervuar në ndarjet buxhetore dhe aktivitetet e parashikuara.

5.1 Kapitali njerëzor

Për të vlerësuar kohezionin mes qeverisjes lokale edhe asaj qendrore, duke ndjekur metodologjinë e sqaruar në fillim, në Komunën e Obiliqit është bërë intervistë me zyrtarë drejtorive të ndryshme. Fillimisht, pasi janë konsultuar dokumentet strategjike Komunale, janë listuar prioritetet e komunës për dy vitet e ardhshme në katër kategori: 'Zhvillimi i kapitalit njerëzor', 'Zhvillimi i Industrive Konkurruese', 'Zhvillimi i Infrastrukturës', dhe 'Zhvillimi i Bujqësisë'.

Në kategorinë e parë – 'Zhvillimi i kapitalit njerëzor', Komuna e Obiliqit ka caktuar tri prioritetet. Siç shihet në Matricën 12, këto prioritetet janë: 1.1. Ndërtimi i shkollave, 1.2. Bursa për studente të nivelit të mesëm dhe të lartë, dhe 1.3. Aftësimi dhe trajnimi i punëtorëve për punësim në KEK. Nga vlerësimi që i është bërë përputhshmërisë së këtyre prioritetëve me ato të qeverisë në po të njëjtën kategori, doli se prioritetet e Obiliqit kanë një përputhshmëri të lartë me prioritetet e qeverisë. Në raport me prioritetin e parë Komunal në këtë kategori (1.1.), prioriteti qeveritar është vlerësuar me rëndësi mesatare. Po ky prioritet qeveritar është vlerësuar të përputhet ngushtë me tri prioritetëve Komunale 'Rritja e përfshirjes

së fëmijëve në institucione parashkollore', 'Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm', 'Përmirësimi i ndërlidhjes ndërmjet shkathtësive të fituara në arsim dhe kërkesave të tregut të punës'. Më ulët është vlerësuar përputhshmëria e këtij prioriteti në raport me dy prioritetet qeveritare 'Ulja e nivelit të punësimit joformal', dhe 'Angazhimi afatshkurtër i ekspertëve dhe studentëve të diasporës'. Lidhshmëria mes këtyre dy prioritetëve qeveritarë dhe prioritetit të parë të komunës është vlerësuar me tre shkallë.

Arritja e prioritetëve të komunës synohet përmes realizimit të projekteve të ndryshme të komunës, për të cilat është vënë në vend procedura për implementim, e aplikueshme në baza të rregullta. Hapat procedural të përfshirë janë: iniciimi i procedurave të prokurimit, zotimi i mjeteve, përzgjedhja e operatorit ekonomik, realizimi i projektit në bazë të kontratës dhe planit dinamik, dhe kontrolli nga komisioni i pranimit teknik përfundimtar. Ndërsa vlerësimi i prioritetëve bëhet në bazë të kriterëve ndaj të cilave vlerësohet dhe raportohet projekti.

MATRICA 13: KAPITALI NJERËZOR – KOMUNA E OBI LIQIT

	Komuna	Qeveria	Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucione parashkollore	Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm	Përmirësimi i ndërlidhjes ndërmjet shkathtësive të fituara në arsim dhe kërkesave të tregut të punës	Forcimi i funksioneve të provimit, inspektimit dhe akreditimit në sistemin arsimor	Përmirësimi i planifikimit të shpenzimeve në sistemin e arsimit	Ulja e nivelit të punësimit joformal	Angazhimi afatshkurtër i ekspertëve dhe studentëve të diasporës
Ndërtimi i shkollave	9	9	9	9	9	7	3	3	
Bursa për studentë të nivelit të mesëm dhe të lartë	9	8	7	7	7	7	9	8	
Aftësimi dhe trajnimi i punëtorëve për punësim në KEK	7	7	7	6	6	6	3	3	

* VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETËVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)

1 2 3 4 5 6 7 8 9

5.2 Industritë konkurruese

Në kategorinë e dytë – 'Zhvillimi i industrive konkurruese', Komuna e Obiliqit ka caktuar vetëm një prioritet i cili është 'Ndërtimi i infrastrukturës në Zonën Industriale (Donator/Komuna / Ministrit e Linjës)' (Matrica 14). Ky prioritet është vlerësuar të jetë i një përputhshmërie mbi mesatare me tri prioritetet qeveritare, në raport me prioritetin Komunal 'Lehtësimi e qasjes në financa për ndërmarrjet kosovare', 'Rrjetëzimi dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të grupuara', 'Kalimi i NVM-ve në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar'. Po i njëjti prioritet Komunal është

vlerësuar të përputhet ngushtë me prioritetin qeveritar 'Rritja e nivelit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) dhe atyre të diasporës'. Në fund, prioritetet qeveritare 'Zhblokimi i fondit të privatizimit dhe përdorimi i mjeteve për zhvillim' dhe 'Qeverisje e mirë dhe performancë e kënaqshme e korporatave me aksione shtetërore' janë vlerësuar jo-relevant krahas prioritetit Komunal në kategorinë e zhvillimit të industrive konkurruese.

MATRICA 14: INDUSTRI TË KONKURRUESE – KOMUNA E OBILIQIT



5.3 Infrastruktura

Në kategorinë e tretë- 'Zhvillimi i Infrastrukturës', Komuna ka caktuar pesë prioritete kryesore: 'Renovimi i ngrohjes qendrore', 'Ndërtimi dhe renovimi i rrugëve në komunë, dhe sinjalizimi i tyre', 'Trajtimi i lumenjve: Sitnica, Drenica dhe Llapi', 'Ndërtimi i rrjetit sekondar të kanalizimit' dhe 'Renovimi dhe zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit' (Matrica 15). Vlerësimi i këtyre prioriteteve në raport me prioritetet qeveritare në të njëjtën kategori ka rezultuar në një notim mesatar ose të ulët. Prioriteti i parë Komunal, 'Renovimi i ngrohjes qendrore' është vlerësuar të jetë me së shumti relevant në raport me prioritetin qeveritar 'Sigurimi i përdorimit të qëndrueshëm të pyjeve të Kosovës', me shtatë shkallë. Ndërsa, dy prioritetet

tjera qeveritare 'Përmirësimi i infrastrukturës mbështetëse për prodhimtarinë bujqësore' dhe 'Racionalizimi i përdorimit të ujit dhe rritja e kapaciteteve prodhuese dhe shpërndarëse' janë vlerësuar jo-relevant në raport me prioritetin e parë të komunës. Përputhshmëria e prioritetit të parë të komunës në Matricën 15 është vlerësuar si mesatare me prioritetet qeveritare 'Rritja e kapacitetit vendor të prodhimit të energjisë elektrike nga linjiti dhe burimet e ripërtëritshme', 'Rritja e përdorimit të teknologjisë informative në operimet e bizneseve, shkollave dhe institucioneve publike', dhe 'Menaxhimi më i qëndrueshëm i mbeturinave'.

MATRICA 15: INFRASTRUKTURA – KOMUNA E OBILIQIT

	Komuna	Qeveria	Rritja e kapacitetit vendor të prodhimit të energjisë elektrike nga linjiti dhe burimet e ripërtëritshme	Investimi në masa të efijencës për konsumin e energjisë	Përfundimi i akteve kryesore ndërkombëtare dhe rajonale rrugore si dhe linja ndërkombëtare hekurudhore	Rritja e përdorimit të teknologjisë informative në operimet e bizneseve, shkollave dhe institucioneve publike	Përmirësimi i infrastrukturës mbështetëse për prodhimtarinë bujqësore	Racionalizimi i përdorimit të ujit dhe rritja e kapaciteteve prodhuese dhe shpërndarëse	Sigurimi i përdorimit të qëndrueshëm të pyjeve të Kosovës	Menaxhimi më i qëndrueshëm i mbeturinave
Renovimi i ngrohjes qendrore	5	4	4	4	5	2	3	7	5	
Ndërtimi dhe renovimi i rrugëve në komunë, sinjalizimit të tyre	3	4	7	7	5	2	2	2	2	
Trajtimi i lumenjve: Sitnica, Drenica dhe Llapi	6	4	3	6	6	6	6	6	6	
Ndërtimi i rrjetit sekondar të kanalizimit	3	2	2	5	5	5	4	5	5	
Renovimi dhe zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit	3	3	3	4	4	6	4	7	7	

* VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)

1 2 3 4 5 6 7 8 9

6.4 Bujqësia

Në kategorinë e fundit të krahasimit të prioriteteve të dy niveleve të qeverisjes, 'Zhvillimi i Bujqësisë', Komuna e Obiliqit ka listuar vetëm një prioritet - 'Subvencione për bujqësi' - Matrica 16. Në raport me prioritetet qeveritare, prioriteti i komunës në këtë kategori është vlerësuar më lartë se në kategoritë e tjera për zhvillim, të diskutuara më lartë. Në mesatare, 'Subvencione për bujqësi', si prioritet Komunal i është dhënë një vlerësim prej shtatë shkallësh. Ky prioritet është vlerësuar si shumë i rëndësishëm në raport me prioritetet e qeverisë qendrore 'Krijimi i ngastrave në formë sa më të rregullt gjeometrike, të

përshtatshme për përdorim të lehtë të mekanizmit bujqësorë, si dhe projekti i Sistemit të Identifikimit të Parcelave (LPIS) dhe 'Formimi i rrjetit të rrugëve fushore, që mundësojnë qasje të drejtpërdrejtë në parcela, si dhe eliminimi i servitutit sezonal – qasja në pronë përmes pronës së dikujt tjetër', të dyja vlerësuar me nëntë shkallë. Në anën tjetër, vlerësimi më i ulët i është bërë përputhshmërisë me prioritetin qendror 'Rritja e numrit të objekteve të deponimit dhe magazinimit në rajonet kryesore të Kosovës përmes Partneriteteve Publiko-Private'.

MATRICA 16: BUJQËSIA – KOMUNA E OBILIQIT

	Qeveria	Komuna	Zgjerimi i mbulueshmërisë së sistemit të ujitjes së paku në 40% të tokës së punueshme deri në 2021	Krijimi i platformës së Sistemit të Integruar Informativ Bujqësor për ta rritur konkurrueshmërinë	Zgjidhja e çështjes së tokave bujqësore të fragmentuara	Rritja e numrit të objekteve të deponimit dhe magazinimit përmes Partneriteteve Publiko-Private	Rritja e numrit të njësive të testimit laboratorik për cilësinë e prodhimit privat të farërave	Financimi i projektit të rregullimit të tokës dhe integrimi në projektet e zhvillimit rural	Reforma strukturore me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për rritjen e prodhimit të bujqësore	Krijimi i ngastrave në formë të rregullt gjeometrike dhe realizimi i projektit të Sistemit të Identifikimit të Parcelave (LPIS)	Formimi i rrjetit të rrugëve fushore dhe eliminimi i servitutit sezonal – qasja në pronë përmes pronës së dikujt tjetër
Subvencione për bujqësi	7	7	7	4	7	7	7	7	9	9	


* VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)

1 2 3 4 5 6 7 8 9



Në përgjithësi, në komunën e Obiliqit vërehet një varietet i përputhshmërisë së prioriteteve të qeverisjes, varësisht prej kategorisë për zhvillim. Në 'Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor', zyrtarë nga Komuna kanë konsideruar një përputhshmëri më të lartë të prioriteteve qendrore dhe lokale. Në kategorinë e 'Zhvillimit të Industrive Konkurruese' ka një vlerësim mesatar të përputhshmërisë, ndërsa në kategorinë e 'Zhvillimit të Infrastrukturës' ka një vlerësim nga mesatar deri në të ulët.

Takimet dhe bashkëpunimi mes ministrive ose qeverisë qendrore dhe Komunës së Obiliqit ngjashëm me Komunat e tjera nuk është i zyrtarizuar përmes ndonjë marrëveshjeje. Takimet ndodhin sipas nevojës dhe kryesisht rrallë. Më e shprehur është nevoja për koordinim në nivel të implementimit të projekteve në Obiliq si Zonë me Interes të Veçantë Ekonomik. Fokus specifik është kërkuar edhe në nevojën e ndërhyrjes së qeverisë në përmirësimin e kushteve të mjedisit në komunë, dhe efekteve shoqërore e ekonomike të shkaktuara nga ndotja nga termocentrali. Qasja më e shpeshtë e shprehur nga Komuna është përmes kërkesave që ata dërgojnë për financimin e projekteve të ndryshme.



6. KOMUNA E GRAÇANICËS

1. Prioritetet strategjike të caktuara nga Komuna e Graçanicës janë:
2. **Infrastruktura Sociale, Strehimi dhe Demografia;**
3. **Avancimi i zhvillimit ekonomik përmes zhvillimit ekonomik, bujqësisë dhe turizmit;**
4. **Shërbimet Publike, Infrastruktura dhe Transporti;** dhe
5. **Mjedisi Jetësor, Resurset Natyrore dhe Trashëgimia Kulturore.**

Këto prioritete, ngjashëm si në Komunat e tjera, janë përcaktuar përmes një procesi gjithëpërfshirës konsultativ, duke mbajtur takime dhe bisedime jo formale me ekspertë, ndërmarrës dhe fermerë. Shqyrtimet e detajuara kanë nxjerrë katër

prioritete kyçe për funksionimin më të mirë dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të komunës së Graçanicës, të vendosura në dokumentin strategjik Plani Zhvillimor Komunal sipas grupeve tematike. Megjithëse, ky Plan Zhvillimor shfrytëzohet si dokument referimi për punën në komunë, pasi që është mjaft konkret dhe i realizueshëm, zyrtarët e komunës kanë deklaruar se për zbatimin e mirëfilltë të planit u mungojnë fondet e mjaftueshme. Për shembull, synimet e planit për këtë vit nuk do të mund të realizohen, por Komuna planifikon t'i ri-alokojnë fondet nga ato infrastrukturore në sistem të ujitjes pikë-pikë në disa fshatra përreth komunës. Komuna e Graçanicës si lëmi kryesore për zhvillim ekonomik e sheh bujqësinë dhe sipas tyre, Komuna posedon tokë shumë cilësore për kultivim, si dhe ekspertë të kësaj fushe për të realizuar këtë plan, por ata theksojnë se nuk janë duke marrë përkrahje të mjaftueshme financiare nga strukturat e tjera, qofshin institucionet shtetërore apo ndërkombëtare.

6.1 Kapitali njerëzor

Kur krahasohen prioritetet e komunës në aspektin e kapitalit njerëzor, atëherë mund të vërehet se ka mjaft përputhshmëri me disa nga prioritetet qeveritare për zhvillimin e kapitalit njerëzor. Prioriteti i parë Komunal, i cili konsiderohet i një rëndësie të madhe, është 'Ngritja e kapaciteteve në fushën e arsimit'. Krahas këtij të fundit, prioriteti qeveritar 'Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucionet parashkollore', është vlerësuar të jetë i një rëndësie mbi mesatare në shkallë prej shtatë pikësh nga nëntë pikë maksimalisht. Dy prioritetet qendrore të radhës 'Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm' dhe 'Përmirësimin e ndërlidhjes ndërmjet shkathtësive të fituara në arsim dhe kërkesave të tregut të punës', janë vlerësuar në përputhshmëri të plotë me prioritetin Komunal në fjalë. Ndërsa katër prioritetet e tjera qendrore janë vlerësuar me shkallë nën-mesatare të rëndësisë dhe përputhshmërisë; si 'Forcimi i funksioneve të provimit, inspektimit dhe akreditimit në sistemin arsimor', 'Përmirësimi i planifikimit të shpenzimeve në sistemin arsimor', 'Ulja e nivelit të punësimit joformal', dhe 'Angazhimi afatshkurtër i ekspertëve dhe studentëve të diasporës'. Përgjithësisht, zyrtarët e komunës së Graçanicës kanë theksuar se zhvillimi i kapitalit

njerëzor është kyç për zhvillimin e mëtutjeshëm ekonomik të komunës. Ata konsiderojnë se kualifikimet specifike, si ato në prodhim dhe agro-teknologji janë shumë më relevante, më të nevojshme dhe të aplikueshme në këtë komunë si dhe në tërë Kosovën, se sa disa drejtime tjera të përhapura shumë gjatë dy dekadave të fundit.

Prioritet tjetër i komunës së Graçanicës, 'Ofrimi i shërbimeve adekuate dhe cilësore', është vlerësuar po ashtu me prioritetet qeveritare për zhvillim të kapitalit njerëzor. Në këtë krahasim, gjithashtu janë vlerësuar me shkallën më të lartë të përputhshmërisë, prioritetet qendrore dy dhe tre 'Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm' dhe 'Përmirësimin e ndërlidhjes ndërmjet shkathtësive të fituara në arsim dhe kërkesave të tregut të punës'. Ndërsa, prioriteti qendror 'Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucionet parashkollore', është vlerësuar të jetë i një rëndësie vetëm mesatare. Prioritetet tjera qendrore janë vlerësuar të jenë të një rëndësie nën-mesatare krahas këtij prioriteti Komunal në fjalë, të cilat janë të paraqitura më detajisht në Matricën 17.

MATRICA 17: KAPITALI NJERËZOR – KOMUNA E GRAÇANICËS

	Komuna	Qeveria	Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucione parashkollore	Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm	Përmirësimi i ndërlidhjes ndërmjet shkathtësive të fituara në arsim dhe kërkesave të tregut të punës	Forcimi i funksioneve të provimit, inspektimit dhe akreditimit në sistemin arsimor	Përmirësimi i planifikimit të shpenzimeve në sistemin e arsimit	Ulja e nivelit të punësimit joformal	Angazhimi afatshkurtër i ekspertëve dhe studentëve të diasporës
Ngritja e kapaciteteve në fushën e arsimit	7	9	9	2	3	5	2		
Ofrimi i shërbimeve adekuate dhe cilësore	6	9	9	4	4	5	4		

* VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 | RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)

1 2 3 4 5 6 7 8 9

6.2 Industritë konkurruese

Vlerësime janë bërë edhe lidhur me industritë konkurruese dhe këtu si prioritet i parë i komunës së Graçanicës është renditur 'Sigurimi i tregut dhe qasja në plasman të prodhimit'. Në raport me këtë prioritet, prioriteti i parë qeveritar 'Lehtësimi e qasjes në financa për ndërmarrjet kosovare', është vlerësuar me mjaft pak rëndësi. Në anën tjetër, prioritetet qeveritare dy dhe tre, 'Rrjetëzimi dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të grupuara', dhe 'Kalimi i NVM-ve në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar', janë vlerësuar të jenë në përputhje të plotë krahas prioritetit Komunal, të dyja të vlerësuara me nga nëntë pikë. Këto dy çështje, janë konsideruar si tejet të rëndësishme për Graçanicën, si dhe për krejt Kosovën, posaçërisht marrë parasysh tregun e vogël, me të cilin karakterizohet si ky qytet ashtu edhe vetë shteti. Është theksuar se, është e domosdoshme përfshirja në kooperativa të fermerëve dhe të përpunuesve për të rritur shitjet dhe fitimin. Vlerësim mesatar ka marrë prioriteti qendror 'Rritja e nivelit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) dhe atyre të diasporës'. Një çështje, e cila sipas zyrtarëve të komunës

së Graçanicës, nuk ka zgjidhje, është 'Zgjidhja e çështjes së tokave bujqësore të fragmentuara', prioritet qendror, ky i cili është vlerësuar jo-relevant. Këtë vlerësim kanë marrë edhe dy prioritetet e tjera qeveritare 'Zhbllokimi i fondit të privatizimit dhe përdorimi i mjeteve për zhvillim' dhe 'Qeverisje e mirë dhe performancë e kënaqshme e korporatave me aksione shtetërore', siç është ilustruar në Matricën 18.

Po ashtu, prioriteti i dytë Komunal 'Nxitja dhe hapja e bizneseve familjare', është vlerësuar krahas prioritetëve qendrorë dhe këtu përputhshmëri të madhe kanë treguar përsëri prioritetet 'Rrjetëzimi dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të grupuara', dhe 'Kalimi i NVM-ve në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar', të dyja të vlerësuara maksimalisht. Prioriteti qendror 'Rritja e nivelit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) dhe atyre të diasporës', është vlerësuar të jetë i një rëndësie mbi mesatare, ndërsa prioritetet tjera qeveritare janë vlerësuar përsëri me rëndësi të një shkalle të vogël dhe të parëndësishme (shih Matricën 18).

MATRICA 18: INDUSTRIË KONKURRUESE – KOMUNA E GRAÇANICËS

Komuna	Qeveria	Lehtësimi e qasjes në financa për ndërmarrjet kosovare	Rrjetëzimi dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të grupuara	Kalimi i NVM-ve në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar	Rritja e nivelit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) dhe atyre të diasporës	Zgjidhja e çështjes së tokave bujqësore të fragmentuara	Zhbllokimi i fondit të privatizimit dhe përdorimi i mjeteve për zhvillim	Qeverisje e mirë dhe performancë e kënaqshme e korporatave me aksione shtetërore
Sigurimi i tregut dhe qasja në plasman të prodhimit		3	9	9	6	1	1	1
Nxitja dhe hapja e bizneseve familjare		3	9	9	7	1	1	1
Zhvillimi dhe promovimi i turizmit lokal		1	6	6	7	1	1	1
Nxitja dhe zhvillimi i biznesit		4	9	9	7	1	1	1



VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)



6.3 Infrastruktura

Komuna e Graçanicës e ka ende mjaft të rëndësishme përmirësimin e infrastrukturës Komunale. Në Matricën 19 janë paraqitur vlerësimet e zyrtarëve të komunës rreth përputhshmërisë së prioriteteve qeveritare me ato lokale lidhur me këtë çështje. I pari është renditur prioriteti 'Mbulueshmëria e rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit në tërë territorin e komunës', krahas të cilit janë vlerësuar mjaft relevant prioritetet qeveritare 'Përmirësimi i infrastrukturës mbështetëse për prodhimtarinë bujqësore' dhe 'Racionalizimi i përdorimit të ujit dhe rritja e kapaciteteve prodhuese dhe shpërndarëse'. Kurse, prioritetet tjera qeveritare në raport me këtë prioritet Komunal janë vlerësuar të gjitha me rëndësi jo aq të madhe. 'Sigurimi i përdorimit të qëndrueshëm të pyjeve të Kosovës' dhe 'Menaxhimi më i qëndrueshëm i mbeturinave', janë vlerësuar, për shembull,

me nga tri pikë. Sa i përket sigurimit të përdorimit të pyjeve, zyrtarët e komunës kanë thënë se ky është prioritet i vonuar, pasi që pyjet tashmë janë prerë në mënyrë ilegale. Pa marrë parasysh se sa adekuat është ligji për mbrojtjen e pyjeve, nuk vlen asgjë nëse nuk arrin të zbatohen dispozitat në kuadër të ligjit. Prioritetet 'Rritja e kapacitetit vendor të prodhimtarisë së energjisë elektrike nga linjiti dhe burimet e ripërtëritshme', 'Investimi në masa të efijencës për konsumin e energjisë', 'Rritja e përdorimit të teknologjisë informative në operimet e bizneseve, shkollave dhe institucioneve publike' dhe 'Përfundimi i akteve kryesore ndërkombëtare dhe rajonale rrugore si dhe linja ndërkombëtare hekurudhore', janë konsideruar krejtësisht jo-relevant.

MATRICA 19: INFRASTRUKTURA – KOMUNA E GRAÇANICËS

Komuna	Qeveria	Rritja e kapacitetit vendor të prodhimtarisë së energjisë elektrike nga linjiti dhe burimet e ripërtëritshme	Investimi në masa të efijencës për konsumin e energjisë	Përfundimi i akteve kryesore ndërkombëtare dhe rajonale rrugore si dhe linja ndërkombëtare hekurudhore	Rritja e përdorimit të teknologjisë informative në operimet e bizneseve, shkollave dhe institucioneve publike	Përmirësimi i infrastrukturës mbështetëse për prodhimtarinë bujqësore	Racionalizimi i përdorimit të ujit dhe rritja e kapaciteteve prodhuese dhe shpërndarëse	Sigurimi i përdorimit të qëndrueshëm të pyjeve të Kosovës	Menaxhimi më i qëndrueshëm i mbeturinave
Mbulueshmëria e rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit në tërë territorin e komunës	2	2	1	2	8	8	3	3	
Përmirësimi i rrjetit të energjisë elektrike si dhe furnizimin me energji elektrike	1	9	1	7	7	7	3	3	
Mbulueshmëria e rrjetit të telekomunikacionit	2	1	1	7	3	1	1	1	
Përmirësimi në menaxhim të mbeturinave të ngurta	3	3	1	1	3	1	1	9	
Pyllëzimi dhe parandalimi i prerjes ilegale të pyllit	3	3	1	1	2	2	9	1	
Shfrytëzimi i burimeve me energji të ripërtëritshme	9	9	1	1	3	3	3	1	
Përmirësimi i cilësisë së ujit, ajrit dhe tokës përmes zgjidhjes së problemit të mbeturinave minerare	3	5	2	1	6	7	3	9	



VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)



6.4 Bujqësia

Në fund, janë vlerësuar, prej një deri në nëntë, prioritetet qendrore krahas atyre Komunale për fushën e bujqësisë. Këtu, prioriteti që konsiderohet më i rëndësishmi nga Komuna e Graçanicës është 'Arritja e prodhimit të qëndrueshëm në bujqësi'. Në raport me këtë prioritet Komunal, prioriteti i parë qeveritar në fushën e bujqësisë, 'Zgjerimi i mbulueshmërisë së sistemit të ujitjes së paku në 40përqind të tokës së punueshme deri në vitin 2021', është vlerësuar të jetë i një rëndësie mjaft të madhe, me shkallë prej tetë pikësh. Megjithatë, zyrtarët e komunës, mendojnë që mbulueshmëria e sistemit të ujitjes në 40 përqind të tokës së punueshme është synim shumë ambicioz, por jo aq i realizueshëm. Më tutje, prioriteti qeveritar 'Rritja e numrit të objekteve të deponimit dhe magazinimit në rajonet kryesore të Kosovës përmes Partneriteteve Publiko-Private', është vlerësuar të përputhet ngushtë me prioritetin e parë Komunal, kjo për shkak se Komuna ende nuk posedon një qendër grumbulluese për mbledhjen dhe ruajtjen e kulturave bujqësore. Dy prioritetet tjera qendrore, 'Krijimi i platformës informative të Sistemit të

Integruar Informativ Bujqësor për ta rritur konkurrueshmërinë në sektorin e bujqësisë' dhe 'Ndërmarrja e reformave strukturore (me theks në masa ligjore dhe institucionale) me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për rritjen e prodhimit bujqësor', janë konsideruar jo shumë të rëndësishëm, krahas prioritetit Komunal. Ndërsa, krejtësisht jo-relevante janë vlerësuar pesë prioritetet e mbetura qeveritare, 'Zgjidhja e çështjes së tokave bujqësore të fragmentuara', 'Rritja e numrit të njësive të testimit laboratorik për cilësinë e prodhimit privat të farërave dhe përmirësimi i standardeve fito-sanitare', 'Përgatitja dhe financimi i projektit të rregullimit të tokës dhe integrimi në projektet e zhvillimit rural', 'Krijimi i ngastrave në formë sa më të rregullt gjeometrike, të përshtatshme për përdorim të lehtë të mekanizmit bujqësorë, si dhe do të realizohet projekti i Sistemit të Identifikimit të Parcelave (LPIS)' dhe 'Formimi i rrjetit të rrugëve fushore, që mundësojnë qasje të drejtpërdrejta në parcela, si dhe eliminimi i servitutit sezonal – qasja në pronë përmes pronës së dikujt tjetër'.

MATRICA 20: BUJQËSIA – KOMUNA E GRAÇNICËS

	Qeveria	Komuna	Zgjerimi i mbulueshmërisë së sistemit të ujitjes së paku në 40% të tokës së punueshme deri në 2021	Krijimi i platformës së Sistemit të Integruar Informativ Bujqësor për ta rritur konkurrueshmërinë	Zgjidhja e çështjes së tokave bujqësore të fragmentuara	Rritja e numrit të objekteve të deponimit dhe magazinimit përmes Partneriteteve Publiko-Private	Rritja e numrit të njësive të testimit laboratorik për cilësinë e prodhimit privat të farërave	Financimi i projektit të rregullimit të tokës dhe integrimi në projektet e zhvillimit rural	Reforma strukturore me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për rritjen e prodhimit bujqësor	Krijimi i ngastrave në formë të rregullt gjeometrike dhe realizimi i projektit të Sistemit të Identifikimit të Parcelave (LPIS)	Formimi i rrjetit të rrugëve fushore dhe eliminimi i servitutit sezonal – qasja në pronë përmes pronës së dikujt tjetër
Arritja e prodhimit të qëndrueshëm në bujqësi	8	5	1	9	1	1	3	1	1		
Ngritja e vetëdijes për një bujqësi të qëndrueshme	7	5	7	7	1	1	1	1	1		
Parandalimi i shfrytëzimit të paligjshëm dhe eksploatimi i tokës bujqësore shoqërore	2	5	2	1	1	2	3	3	3		
Mbrojtja e tokës bujqësore nga ndikimet kimike (mjeteve agroteknike)	2	1	1	1	1	1	3	1	1		




VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)





Sa i përket bashkëpunimit me nivelin qendror, zyrtarët e komunës së Graçanicës, ashtu si zyrtarët e Komunave tjera, kanë deklaruar se prioritetet Komunale i përpilojnë vetë, bazuar në kërkesat dhe nevojat e komunës. Komunikimi në përgjithësi është i mirë dhe i rregullt edhe pse konsiderojnë se ka shumë hapësirë për përmirësim. Më produktiv është bashkëpunimi dhe konsultimi lidhur me çështjet administrative, përpilimin e buxhetit dhe aftësimin profesional, i cili ofrohet vazhdimisht nga zyrtarët qeveritar.



7. KOMUNA E LIPJANIT

Komuna e Lipjanit ka përqendruar aktivitetet e saj për dy vitet e ardhshme në tri prioritetet kryesore. Këto prioritetet janë:

1. **Përmirësimi i kushteve për zhvillim të strukturës ekonomike për ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM),**
2. **Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm të zhvillimit të bujqësisë dhe zonave rurale, dhe**
3. **Ngritja e kapaciteteve të fuqisë së lirë punëtore.**

Si bazë që shërben për orientimin e zhvillimit të komunës, tri prioritetet kryesore qëndrojnë në kohezion me prioritetet e qeverisjes qendrore të definuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021.

Identifikimi i prioritetëve kryesore është bërë krahas identifikimit të hapësirave me më së shumti potencial për zhvillim në Komunën e Lipjanit. Ky proces ka ndodhur gjatë hartimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2012-2017 (SZHEL) nga ekipi i përbërë prej zyrtarëve të komunës dhe ekspertëve të kontraktuar për shërbime të konsulencës. Në intervistën e realizuar në Komunën e Lipjanit, zyrtarët treguan se SZHEL ka shërbyer si dokument kyç për ankorimin e Planit për Zhvillim Komunal (PZHK) dhe aktivitete të tjera që kanë për qëllim zhvillimin ekonomik. Për më tepër, ata konsiderojnë se SZHEL është përdorur edhe si udhërrëfyes për përpilimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2017-2019, duke krijuar kështu edhe përputhshmërinë e duhur mes kapaciteteve financiare Komunale dhe prioritetëve të definuar me planifikim strategjik. Pra, Komuna vlerëson se është siguruar që shpenzimet për

projektet që janë të parapara të mbulohen me mjete adekuate nga të hyrat vetanake, grantet qeveritare, dhe donacionet. Si rrjedhojë, pritjet janë që PZHK të realizohet brenda periudhës së caktuar.

Ka raste që projektet specifike brenda PZHK zëvendësohen me projekte të reja, dhe adoptime të tilla konsiderohen si të pae-vitueshme për shkak të zhvillimeve në planifikim të qeverisjes qendrore dhe kërkesave të reja që paraqiten në komunitetin lokal. Për shembull, sipas zyrtarit të komunës së Lipjanit, më parë në Komunën e Lipjanit aktivitetet bujqësore nuk kanë qenë shumë intensive në kultivimin e frutave të malit, mirëpo me ndryshimin strategjik të qeverisjes qendrore dhe orientimin kombëtar të bujqësisë në kultivimin e fruta të malit, është bërë edhe riorientimi i mbështetjes Komunale. Në tërësi, sidoqoftë, ndryshimet që bëhen brenda PZHK mbajnë për bazë mbështetjen e prioritetëve strategjike Komunale duke siguruar në këtë mënyrë konsistencë në qeverisje lokale.

7.1 Kapitali njerëzor

Në sektorin e kapitalit njerëzor është vlerësuar përputhshmëria mes prioriteteve qendrore dhe atyre lokale me shkallë prej një deri nëntë, ku një është shkalla më e ulët (që tregon se nuk ka aspak përputhshmëri në mes të dy prioriteteve) dhe nëntë është shkalla më e lartë (që tregon se ka shumë përputhshmëri në mes të dy prioriteteve). Me anë të zhvillimit të intervistave me zyrtarët Komunal dhe analizës së strategjive lokale të komunës së Lipjanit janë renditur prioritetet Komunale si në vijim; pra prioritetet e komunës së Lipjanit në sektorin e kapitalit njerëzor janë, 1) Menaxhimi cilësor dhe efikas në sistemin arsimor, 2) Përgatitja profesionale e kuadrit arsimor të gjitha niveleve, 3) Cilësia e të nxëniet i bazuar në standarde të vendeve të zhvilluara, 4) Përgatitja profesionale e kuadrit arsimor të të gjitha niveleve, 5) Gjithë-përfshirje, barazim dhe respektim i të nxëniet në arsim, 6) Arsim i qëndrueshëm me zhvillimet globale ekonomike dhe shoqërore, dhe 7) Avancim i gjendjes materiale të arsimit’.

Në raport me prioritetin 1) Menaxhimi cilësor dhe efikas në sistemin arsimor të Komunës së Lipjanit, prioriteti i parë qendror ‘Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucionet parashkollore’ është vlerësuar me shkallë shumë të lartë të përputhshmërisë, me tetë pikë. Prioriteti i dytë qendror sipas renditjes, ‘Përmirësimi i cilë-

sisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm’ në relacion me prioritetin e njëjtë të Komunës së Lipjanit është vlerësuar me shkallë mesatare. Pastaj, prioriteti i tretë i qeverisë, përkatësisht ‘Përmirësimi i ndërlidhjes ndërmjet shkathtësive të fituara në arsim dhe kërkesave të tregut të punës’ është vlerësuar të jetë i një rëndësie mbi mesatare në raport me prioritetin e parë Komunal. Ndër prioritetet qendrore me përputhshmëri më të vogël në raport me prioritetin e parë të komunës së Lipjanit janë ‘Ulja e nivelit të punësimit joformal’ dhe ‘Angazhimi afatshkurtër i ekspertëve dhe studentëve të diasporës’.

Në matricën e kapitalit njerëzor për komunën e Lipjanit, me përputhshmëri më të madhe për sa i përket prioriteteve qeveritare është vlerësuar të jetë ‘Përmirësimi i planifikimit të shpenzimeve në sistemin arsimor’, i vlerësuar me mbi shtatë pikë për secilin prioritet Komunal, përderisa përputhshmërinë më të vogël e kanë pasur prioritetet qeveritare si ‘Ulja e nivelit të punësimit joformal’ dhe ‘Angazhimi afatshkurtër i ekspertëve dhe studentëve të diasporës’, të dyja këto kryesisht të vlerësuara me nën tre pikë. Rëndësia e lart për ‘Përmasimin e planifikimit të shpenzimeve në sistemin arsimor’ vjen si rezultat i ndërlidhjes së ngushtë të secilit prioritet Komunal me ndarjet buxhetore.

MATRICA 21: KAPITALI NJERËZOR – KOMUNA E LIPJANIT

	Komuna	Qeveria	Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucione parashkollore	Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm	Përmirësimi i ndërlidhjes ndërmjet shkathtësive të fituara në arsim dhe kërkesave të tregut të punës	Forcimi i funksioneve të provimit, inspektimit dhe akreditimit në sistemin arsimor	Përmirësimi i planifikimit të shpenzimeve në sistemin e arsimit	Ulja e nivelit të punësimit joformal	Angazhimi afatshkurtër i ekspertëve dhe studentëve të diasporës
Menaxhimi cilësor dhe efikas në sistemin arsimor	8	6	7	6	7	1	1	1	
Përgatitja profesionale e kuadrit arsimor të gjitha niveleve	9	9	6	1	6	1	1	1	
Cilësia e të nxëniet i bazuar në standarde të vendeve të zhvilluar’	7	9	6	1	6	1	1	1	
Përgatitja profesionale e kuadrit arsimor të të gjitha niveleve	9	9	7	1	7	2	2	2	
Gjithë-përfshirje, barazim dhe respektim i të nxëniet në arsim	8	8	8	1	8	1	1	1	
Avancim i gjendjes materiale të arsimit’	9	9	9	1	9	5	1	1	



VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSË MË TË ULËT, 9 RËNDËSË MË TË LARTË)



7.2 Industritë konkurruese

Gjatë shqyrtimit të prioriteteve të kategorisë së dytë -Zhvillimi i Industrive Konkurruese, intervista e realizuar me zyrtarë të Komunës së Lipjanit fillimisht u përqendrua në renditjen e prioriteteve për zhvillim të industrive konkurruese. Nga kjo doli se prioritetet kryesore për zhvillimin e NVM-ve janë 1.1. Përmirësimi kushteve për zhvillim të bizneseve dhe ndërmarrësisë, 1.2. Forcimi i mbështetjes institucionale për NVM, 1.3. Krijimi i kushteve të favorshme për tërheqjen e investimeve nga sektori privat dhe i huaj - Promovimi i Komunës si ambient pozitiv biznesor, 1.4. Krijimi i katër Grupeve ekonomike të reja në principin e klasterëve dhe 1.5. Zhvillimi i Turizmit.

Më pas, zyrtarët Komunal kanë krahasuar secilin prioritet lokal me secilin prioritet qendror në shkallë nga një deri në nëntë, duke përcjellë strukturën e matricave krahasuese. Kjo rezultoi në një vlerësim të lartë të përputhshmërisë mes prioriteteve lokale dhe atyre qendrore për zhvillim të industrive konkurruese (Matrica 22); mesatarisht, udhëheqësit Komunal vlerësuan me mbi shtatë përputhshmërinë mes prioriteteve lokale më të rëndësishme në kategorinë e zhvillimit të industrive konkurruese lokale (prioritetet 1.1, 1.2, 1.3) në relacion me ato të qeverisë qendrore.

Në raport me prioritetin e parë Komunal në këtë lëmi, 'Përmirësimi kushteve për zhvillim të bizneseve dhe ndërmarrësisë', prioritetet

qeveritare 'Lehtësimi i qasjes në financa për ndërmarrjet kosovare', 'Kalimi i NVM-ve në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar' dhe 'Rritja e nivelit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) dhe atyre të diasporës' u vlerësuan në shkallë prej nëntë pikësh. Duke e bërë të qartë kështu fokusin e përbashkët të qeverisë dhe komunës në krijimin e kushteve themelore që mbështesin zhvillimin e NVM-ve.

Prioriteti i komunës, 1.5. 'Zhvillimi i turizmit' edhe pse u vlerësua si relevant ndaj prioriteteve qeveritare mbi mesatare, është konsideruar të hasë probleme me qeverisjen qendrore. Këto probleme janë kryesisht rezultat i faktit që në Komunën e Lipjanit gjenden Shpella e Gadimës dhe Parku Blinaja- pasuri këto të rëndësishme kombëtare, menaxhimi i të cilave është kompetencë e nivelit qendror. Si pasojë, Komuna e konsideron turizmin si segment jashtëzakonisht të rëndësishëm dhe beson që potenciali që ofrohet nga këto atraksione turistike nuk arrihet të shfrytëzohet për shkak se Qeveria nuk është shumë e orientuar në zhvillimin e tyre.

Ndërsa, si barriera për arritjen e prioriteteve Komunale në përgjithësi, doli se problemet pronësore dhe juridike, vonesat për shkak të përsëritjeve, dhe ankesat gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit janë problemet më të zakonshme me të cilat Komuna përballet.

MATRICA 22: INDUSTRIË KONKURRUESE – KOMUNA E LIPJANIT

	Lehtësimi e qasjes në financa për ndërmarrjet kosovare	Rrjetëzimi dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të grupuara	Kalimi i NVM-ve në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar	Rritja e nivelit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) dhe atyre të diasporës	Zgjidhja e çështjes së tokave bujqësore të fragmentuara	Zhblokimi i fondit të privatizimit dhe përdorimi i mjeteve për zhvillim	Qeverisje e mirë dhe performancë e kënaqshme e korporatave me aksione shtetërore
Përmirësimi kushteve për zhvillim të bizneseve dhe ndërmarrësisë	9	8	9	9	2	6	7
Mbështetje institucionale për NVM	8	6	6	8	5	9	7
Krijimi i kushteve të favorshme për tërheqjen e investimeve nga sektori privat dhe i huaj	8	5	7	9	5	8	7
Krijimi i katër Grupeve ekonomike të reja në principin e klasterëve	8	8	6	7	6	6	8
Zhvillimi i turizmit	8	6	8	8	5	5	6



VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)



7.3 Infrastruktura

Më tutje, në kuadër të vlerësimit të prioriteteve të kategorisë së tretë në këtë studim, pra- atyre që kanë të bëjnë me infrastrukturën, zyrtarët Komunal fillimisht kanë listuar prioritetet përkatëse. Në këtë kategori të zhvillimit, vërehet një orientim i planifikimit Komunal drejt investimeve në transport dhe zhvillim të qëndrueshëm, kanalizim dhe mbeturina. Siç shihet në Matricën 23, tri prioritetet kryesore të listuar janë 2.1. 'Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës së transportit dhe ndërlidhja me korridoret shtetërore', 2.2. 'Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës së transportit në parim të zhvillimit të qëndrueshëm' dhe 2.3. 'Zgjerimi dhe përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, si dhe rrjeti i kanaleve për kullim, dhe rregullimin e ujërave sipërfaqësor'.

Në përgjithësi, kur prioritetet e Komunës së Lipjanit në kategorinë e 'Zhvillimit të Infrastrukturës' janë krahasuar me përputhshmërinë e tyre me prioritete të qeverisë, ato janë vlerësuar mjaft lartë. Prioriteti i parë i komunës sipas renditjes (2.1), vlerësuar ndaj tetë prioriteteve të qeverisë në kategorinë e Zhvillimit të Infrastrukturës konsiderohet si më i rëndësishmi ndaj prioriteteve qeveritare 'Përfundimi i akteve kryesore ndërkombëtare dhe rajonale rrugore si dhe linja ndërkombëtare hekurudhore'- dhe 'Rritja e përdorimit të teknologjisë informative në operimet e bizneseve, shkollave dhe institucioneve publike'. Këto prioritete janë vlerësuar me nëntë edhe tetë pikë, respektivisht. Këto dy prioritete mbeten po ashtu të vlerësuara si më relevantët edhe kur krahasohen me të gjitha prioritetet Komunale.

MATRICA 23: INFRASTRUKTURA – KOMUNA E LIPJANIT

Komuna	Qeveria	Rritja e kapacitetit vendor të prodhimit të energjisë elektrike nga linjtë dhe burimet e ripërtëritshme	Investimi në masa të efijencës për konsumin e energjisë	Përfundimi i akteve kryesore ndërkombëtare dhe rajonale rrugore si dhe linja ndërkombëtare hekurudhore	Rritja e përdorimit të teknologjisë informative në operimet e bizneseve, shkollave dhe institucioneve publike	Përmirësimi i infrastrukturës mbështetëse për prodhimtarinë bujqësore	Racionalizimi i përdorimit të ujit dhe rritja e kapaciteteve prodhuese dhe shpërndarëse	Sigurimi i përdorimit të qëndrueshëm të pyjeve të Kosovës	Menaxhimi më i qëndrueshëm i mbeturinave
Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës së transportit (rrugët, hekurudha) dhe ndërlidhja me korridoret shtetërore (autostradat e planifikuara).	1	6	9	8	7	7	6	7	
Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës së transportit në parim të zhvillimit të qëndrueshëm	7	7	9	8	7	7	7	7	
Zgjerimi dhe përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, si dhe rrjeti i kanaleve për kullim, dhe rregullimin e ujërave sipërfaqësor.	6	8	5	8	8	9	7	6	
Përmirësimi i kushteve për mbrojtjen e mjedisit	6	9	5	8	7	7	8	5	
Krijimi i infrastruktures fizike dhe institucionale në parim të zhvillimit të qëndrueshëm.	9	7	9	8	7	8	7	8	
Furnizimi me ujë	6	6	6	2	9	9	7	7	
Menaxhimi, grumbullimi, transportimi dhe trajtimi i ujërave të zeza dhe mbeturinave.	5	7	7	5	5	7	6	9	
Ngritja e kualitetit dhe siguria e konsumatorëve me furnizimin me energji elektrike.	9	8	7	8	7	7	7	5	



VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSË MË TË ULËT, 9 RËNDËSË MË TË LARTË)



7.4 Bujqësia

Në sektorin e bujqësisë për komunën e Lipjanit janë renditur këto prioritete: 1) Krijimi i bazës së të dhënave për ekonominë bujqësore në Komunën e Lipjanit, 2) Trajnimi i prodhuesve bujqësor, 3) Organizimi i panairit të prodhuesve bujqësor, 4) Ngritja e kapaciteteve për përpunimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore, 5) Investime në pajisjet për ujitje, 6) Zhvillimi i prodhimtarisë në degët alternative të bujqësisë, 7) Ngritja e kapaciteteve prodhuese në pemëtari, 8) Ngritja e serave, dhe 9) Shfrytëzimi i kapaciteteve për prodhimin e bimëve industriale.

Përputhshmëria e prioriteteve për sektorin e bujqësisë në komunën e Lipjanit është vlerësuar të jetë e ndryshueshme. Kështu, rëndësia e prioritetit qeveritar 'Zgjerimi i mbulueshmërisë së sistemit të ujitjes së paku në 40 përqind të tokës së punueshme deri në vitin 2021' për prioritetet Komunale katër, pesë, gjashtë dhe shtatë, është vlerësuar me rëndësi relativisht të madhe, gjegjësisht për prioritetet 4) Ngritja e kapaciteteve për përpunimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore, 5) Investime në pajisjet për ujitje 6) Zhvillimi i prodhimtarisë në degët alternative të bujqësisë dhe 7) Ngritja e kapaciteteve prodhuese në pemëtari.

MATRICA 24: BUJQËSIA – KOMUNA E LIPJANIT

	Qeveria	Komuna	Zgjerimi i mbulueshmërisë së sistemit të ujitjes së paku në 40% të tokës së punueshme deri në 2021	Krijimi i platformës së Sistemit të Integruar Informativ Bujqësor për ta rritur konkurrueshmërinë	Zgjidhja e çështjes së tokave bujqësore të fragmentuara	Rritja e numrit të objekteve të deponimit dhe magazinimit përmes Partneriteteve Publiko-Private	Rritja e numrit të njësive të testimit laboratorik për cilësinë e prodhimin privat të farërave	Financimi i projektit të rregullimit të tokës dhe integrimi në projektet e zhvillimit rural	Reforma strukturore me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për rritjen e prodhimtarisë bujqësore	Krijimi i ngastrave në formë të rregullt gjeometrike dhe realizimi i projektit Sistemit të Identifikimit të Parcelave (LPIS)	Formimi i rrjetit të rrugëve fushore dhe eliminimi i servitutit sezonal – qasja në pronë përmes pronës së dikujt tjetër
Krijimi i bazës së të dhënave për ekonominë bujqësore në KK	1	9	1	2	2	1	1	3	1		
Trajnimi i prodhuesve bujqësor	2	1	4	1	3	3	3	1	1		
Organizimi i panairit të prodhuesve bujqësor	1	8	1	1	1	1	3	1	1		
Ngritja e kapaciteteve për përpunimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore	8	1	1	9	2	2	2	3	1		
Investime në pajisjet për ujitje	9	1	1	2	1	2	1	1	1		
Zhvillimi i prodhimtarisë në degët alternative	8	1	1	1	3	2	1	1	1		
Ngritja e kapaciteteve prodhuese në pemëtari	8	1	7	1	1	4	1	1	1		
Ngritja e serave	5	1	3	1	1	1	1	1	1		
Shfrytëzimi i kapaciteteve për prodhimin e bimëve industriale	7	1	8	1	1	9	1	1	1		




VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)





Bashkëpunimi i qeverisjes qendrore me atë lokale nuk është proces i caktuar formalisht. Qeveria qendrore besohet të jetë më prezentë në aktivitetet e komunës që kanë të bëjnë me çështje administrative dhe përpilim të buxhetit. Takime të tjera mes komunës dhe qeverisë qendrore kryesisht ndodhin përmes Asociacionit të Komunave dhe janë të rralla.

Një shembull i bashkëpunimit zyrtar mes dy niveleve të qeverisjes është Zyra për licencimin e Bizneseve në Lipjan, përmes themelimit të së cilës është bërë delegimi i kompetencave të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë drejt komunës, në mënyrë që të lehtësohet procedura e themelimit të bizneseve.



8. KOMUNA E DRENASIT

Prioritetet e komunës së Drenasit për zhvillim të mëtutjeshëm lokal janë:

1. **Promovimi i Zhvillimit Ekonomik përmes Fuqizimit të Sektorit Privat;**
2. **Avancimi i Kapaciteteve Administrative dhe Infrastrukturore Komunale;** dhe
3. **Avancimi i Sistemit Shëndetësor, Arsimor, Kulturor dhe të Mirëqenies.**

Këto prioritete, sipas zyrtarëve të Komunës së Drenasit, janë përcaktuar në bazë të vlerësimeve paraprake në komunë si dhe të bisedimeve e konsultimeve me biznese, organizata lokale dhe ekspertë të fushave të ndryshme. Këto prioritete bashkë me synimet strategjike dhe projektet konkrete, janë të ankoruara në Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal për vitet

2015-2019. Në komunë i referohen kësaj strategjie për realizimin e synimeve dhe lista e projekteve e hartuar në kuadër të strategjisë i përcjellët çdo drejtorie për qëllim të zbatimit sa më përpiktë. Zyrtarët e komunës thonë se, kjo strategji është konkrete dhe e realizueshme brenda periudhës së caktuar, megjithatë problem paraqesin mjetet e disponueshme. Sipas tyre, fondet që i ka Komuna në dispozicion, janë të pamjaftueshme për zbatimin e të gjitha aktiviteteve, projekteve dhe investimeve të parapara për periudhën e paraparë. Për këtë arsye shpesh janë detyruar në të kaluarën t'i bartin projektet nga viti në vit. Nga strategjia e kaluar, për shembull, kanë mbetur 50 përqind të projekteve të përcaktuara. Megjithatë, kjo ka qenë edhe për shkak të numrit të madh të projekteve infrastrukturore në të cilat ka investuar Komuna e Drenasit aso kohe. Andaj ata mendojnë se kësaj radhe do të realizohet një përqindje shumë më e madhe e projekteve.

8.1 Kapitali njerëzor

Në vijim, zyrtarët e komunës i kanë renditur prioritetet e Drenasit sipas përputhshmërisë dhe i kanë krahasuar me prioritetet qeveritare. Në fushën e kapitalit njerëzor është vlerësuar rëndësia mes prioritetëve në fjalë me shkallë prej një deri nëntë, e cila tregon përputhshmëri të ulët deri të lartë. Prioriteti i renditur i pari në këtë komunë për nga rëndësia është 'Ngritja e njohurive të mësimdhënësve nëpërmjet ndjekjes së programeve të avancuara të mësimdhënies dhe mësim-nxënies'. Prioriteti i parë i nivelit qendror është 'Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucionet parashkollore', i cili është vlerësuar të jetë i një rëndësie nën-mesatare, krahas prioritetit të parë Komunal; për dallim nga prioriteti qendror i radhës 'Përmirësimi i cilësisë së mësim-

dhënies në arsimin fillor dhe të mesëm', i cili është vlerësuar të tregojë përputhshmëri shumë të madhe me prioritetin Komunal në fjalë. Prioriteti i parë Komunal është vlerësuar edhe në raport me 'Përmirësimin e ndërlidhjes ndërmjet shkathësive të fituara në arsim dhe kërkesave të tregut të punës', prioritet ky i cili është konsideruar të ketë rëndësi po ashtu të madhe. Ndërsa katër prioritetet e tjera qendrore 'Forcimi i funksioneve të provimit, inspektimit dhe akreditimit në sistemin arsimor', 'Përmirësimi i planifikimit të shpenzimeve në sistemin arsimor', 'Ulja e nivelit të punësimit joformal' dhe 'Angazhimi afatshkurtër i ekspertëve dhe studentëve të diasporës', janë vlerësuar të jenë të një rëndësie nën-mesatare.

MATRICA 25: KAPITALI NJERËZOR – KOMUNA E DRENASIT

	Komuna	Qeveria	Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucione parashkollore	Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm	Përmirësimi i ndërlidhjes ndërmjet shkathësive të fituara në arsim dhe kërkesave të tregut të punës	Forcimi i funksioneve të provimit, inspektimit dhe akreditimit në sistemin arsimor	Përmirësimi i planifikimit të shpenzimeve në sistemin e arsimit	Ulja e nivelit të punësimit joformal	Angazhimi afatshkurtër i ekspertëve dhe studentëve të diasporës
Ngritja e njohurive të mësimdhënësve nëpërmjet ndjekjes së programeve të avancuara	5	9	7	3	4	4	4	4	
Krijimi i partneriteteve ndërmjet komunës, Feronikelit dhe Parkut të Biznesit për angazhimin e të rinjve në punë praktike	5	7	9	3	5	6	5		
Riorganizimi i profileve të shkollave profesionale sipas kërkesave të tregut të punës	5	7	9	3	5	5	4		
Krijimi i mundësive për qëndrim tërë ditë të nxënësve në shkollë	4	5	3	3	6	3	3		
Pajisja e shkollave me kabinate dhe pajisje tjera të nevojshme	4	5	6	3	6	3	3		
Bashkërendimi i aktiviteteve për monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të procesit arsimor	5	7	7	7	6	4	4		
Nxiti e bashkëpunimeve dhe partneriteteve me sektorin privat dhe institucione e organizata nga vendi dhe jashtë	4	6	8	4	4	4	3		
Krijimi i kushteve në gjithë përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione të rregullta arsimore	5	6	7	5	6	3	3		
Ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së objekteve shkollore	4	5	6	4	6	3	3		



VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)



8.2 Industritë konkurruese

Vlerësime të prioriteteve qendrore me ato Komunale janë dhënë edhe për industrinë konkurruese. Këtu, prioriteti i parë i komunës së Drenasit është 'Promovimi i investimeve vendore dhe të huaja'. Dy prioritetet e para qendrore, të cilat janë krahasuar me këtë prioritet Komunal, 'Lehtësimi e qasjes në financa për ndërmarrjet kosovare' dhe 'Rrjetëzimi dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të grupuara', nuk janë vlerësuar të kenë rëndësi të madhe, prej tri dhe pesë pikësh, respektivisht. Ndërsa, dy prioritetet qendrore të radhës, «Kalimi i NVM-ve në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar» dhe «Rritja e nivelit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) dhe atyre të diasporës», janë vlerësuar të jenë të një rëndësie mbi mesatare. Përderisa, prioriteti i pestë qendror 'Zgjidhja e çështjes së tokave bujqësore të fragmentuara', është konsideruar me shkallë relativisht të ulët të rëndësisë, prioritetet qendrore gjashtë dhe shtatë 'Zhbllokimi i fondit të privatizimit dhe përdorimi i mjeteve për zhvillim' dhe

'Qeverisje e mirë dhe performancë e kënaqshme e korporatave me aksione shtetërore', janë konsideruar prioritetet më jo-relevante krahas prioritetit Komunal në fjalë.

Një prioritet tjetër, i cili konsiderohet i rëndësishëm për komunën, është 'Krijimi i mëturjeshëm i lehtësirave për zhvillimin e bizneseve dhe degëve (klasterëve) biznesorë'. Lidhur me këtë prioritet Komunal, tri prioritetet qendrore kanë marrë vlerësim më të lartë sa i përket rëndësisë. 'Rrjetëzimi dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të grupuara', është vlerësuar me shkallën më të madhe të përputhshmërisë, prej nëntë pikësh, 'Kalimi i NVM-ve në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar', është vlerësuar me shkallë prej tetë pikësh dhe 'Rritja e nivelit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) dhe atyre të diasporës', është vlerësuar me shkallë prej shtatë pikësh (siç mund të shihet në Matricën 26).

MATRICA 26: INDUSTRIË KONKURRUESE – KOMUNA E DRENASIT

Komuna	Qeveria	Lehtësimi e qasjes në financa për ndërmarrjet kosovare	Rrjetëzimi dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të grupuara	Kalimi i NVM-ve në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar	Rritja e nivelit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) dhe atyre të diasporës	Zgjidhja e çështjes së tokave bujqësore të fragmentuara	Zhbllokimi i fondit të privatizimit dhe përdorimi i mjeteve për zhvillim	Qeverisje e mirë dhe performancë e kënaqshme e korporatave me aksione shtetërore
Promovimi i investimeve vendore dhe të huaja	3	5	7	8	3	1	1	
Shfrytëzimi efikas i resurseve natyrore në të mirë të komunitetit	2	4	6	7	3	3	1	
Krijimi i mëturjeshëm i lehtësirave për zhvillimin e bizneseve dhe degëve (klasterëve) banesorë;	5	9	8	7	3	1	1	
Nxitja dhe përkrahja e ndërmarrjes tek të rinjtë përmes organizimeve të trajnimeve në fushën e ndërmarrjes	3	3	3	4	2	4	4	
Shfrytëzimi efikas i pasurive natyrore minerare sipas synimeve strategjike afatgjata	3	2	5	6	5	6	6	



VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)



8.3 Infrastruktura

Tek prioritetet infrastrukturore, i pari është renditur prioriteti 'Ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës rrugore të qarkullimit të njerëzve, mallrave dhe krijimit të mëturshëm të lehtësirave për zhvillimin e biznesit'. Ky prioritet Komunal është krahasuar me tetë prioritetet qeveritare, por vetëm njëri nga prioritetet qeveritare është vlerësuar të ketë përputhshmëri më të lartë, gjegjësisht prioriteti 'Përmirësimi i infrastrukturës mbështetëse për prodhimtarinë bujqësore', me shkallë prej tetë pikësh. Dy prioritete tjera qeveritare 'Investimi në masa të eficiencës për konsumin e energjisë' dhe 'Rritja e përdorimit të teknologjisë informative në operimet e bizneseve, shkollave dhe institucioneve publike', janë vlerësuar të jenë vetëm të një rëndësie mesatare, krahas prioritetit Komunal në fjalë. Të gjitha prioritetet tjera qeveritare janë vlerësuar të një rëndësie të vogël, si 'Racionalizimi i përdorimit të ujit dhe rritja e kapaciteteve prodhuese dhe shpërndarëse', 'Sigurimi i përdorimit të qëndrueshëm të pyjeve të Kosovës' dhe 'Menaxhimi më i qëndrueshëm i mbeturinave'. Së fundi, prioritetet qeveritare

'Rritja e kapacitetit vendor të prodhimit të energjisë elektrike nga linjiti dhe burimet e ripërtëritshme' dhe 'Përfundimi i akteve kryesore ndërkombëtare dhe rajonale rrugore si dhe linja ndërkombëtare hekurudhore', janë konsideruar jo-relevante nga Komuna e Drenasit krahas prioritetit të tyre të parë.

'Ndërtimi, funksionalizimi dhe mirëmbajtja e sistemit të ujësjellësit, si dhe shfrytëzimi i burimeve alternative' është një tjetër prioritet i rëndësishëm i komunës. Krahas këtij, me rëndësi të madhe janë vlerësuar prioritetet qeveritare 'Investimi në masa të eficiencës për konsumin e energjisë' dhe 'Racionalizimi i përdorimit të ujit dhe rritja e kapaciteteve prodhuese dhe shpërndarëse', të dyja me nga tetë pikë. Po ashtu, dy prioritetet e tjera qendrore infrastrukturore 'Rritja e kapacitetit vendor të prodhimit të energjisë elektrike nga linjiti dhe burimet e ripërtëritshme' dhe 'Përmirësimi i infrastrukturës mbështetëse për prodhimtarinë bujqësore', janë konsideruar të jenë të një rëndësie me shkallë mbi mesatare.

MATRICA 27: INFRASTRUKTURA – KOMUNA E DRENASIT

Komuna	Qeveria	Rritja e kapacitetit vendor të prodhimit të energjisë elektrike nga linjiti dhe burimet e ripërtëritshme	Investimi në masa të eficiencës për konsumin e energjisë	Përfundimi i akteve kryesore ndërkombëtare dhe rajonale rrugore si dhe linja ndërkombëtare hekurudhore	Rritja e përdorimit të teknologjisë informative në operimet e bizneseve, shkollave dhe institucioneve publike	Përmirësimi i infrastrukturës mbështetëse për prodhimtarinë bujqësore	Racionalizimi i përdorimit të ujit dhe rritja e kapaciteteve prodhuese dhe shpërndarëse	Sigurimi i përdorimit të qëndrueshëm të pyjeve të Kosovës	Menaxhimi më i qëndrueshëm i mbeturinave
Ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës rrugore	1	6	1	6	8	4	4	4	
Investimet për përmirësimin e infrastrukturës shkollore	1	1	1	7	2	1	2	3	
Ndërtimi i rrugëve të reja, rregullimi i rrugëve ekzistuese, ndriçimi, ndërtimi i trotuareve, hapësirave të gjelbra dhe parqeve	2	2	6	4	3	2	2	2	
Ngritja e sistemeve të kanalizimeve nëpër vendbanime të ndryshe si dhe rregullimi i atyre ekzistuese	2	2	3	2	5	5	4	9	
Ngritja e impianteve dhe kolektorëve për trajtimin e ujërave të zeza	3	3	2	4	5	3	3	5	
Ndërtimi, funksionalizimi dhe mirëmbajtja e sistemit të ujësjellësit, si dhe shfrytëzimi i burimeve alternative	6	6	1	3	4	7	3	5	



VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)



8.4 Bujqësia

Sektori i bujqësisë konsiderohet ndër sektorët më të rëndësishëm në komunën e Drenasit dhe kjo e fundit punon shumë në zhvillimin e mëtutjeshëm të këtij sektori dhe në përmirësimin e kushteve për fermerët. Prioriteti i parë në këtë fushë është 'Krijimi i një sistemi sektorial bujqësor intensiv dhe të qëndrueshëm ekonomikisht'. Krahas këtij, prioriteti qeveritar 'Zgjerimi i mbulueshmërisë së sistemit të ujitjes së paku në 40 përqind të tokës së punueshme deri në vitin 2021', është vlerësuar të jetë i një rëndësie mesatare, njëjtë si edhe prioriteti tjetër qeveritar 'Ndërmarrja e reformave strukturore (me theks në masa ligjore dhe institucionale) me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për rritjen e prodhimtarisë bujqësore'. Prioritetet dy, tetë dhe nëntë qeveritare 'Krijimi i platformës informative të Sistemit të Integruar Informativ Bu-

jqësor për ta rritur konkurrueshmërinë në sektorin e bujqësisë', 'Krijimi i ngastrave në formë sa më të rregullt gjeometrike, të përshtatshme për përdorim të lehtë të mekanizmit bujqësorë, si dhe do të realizohet projekti i Sistemit të Identifikimit të Parcelave (LPIS)' dhe 'Formimi i rrjetit të rrugëve fushore, që mundësojnë qasje të drejtpërdrejtë në parcela, si dhe eliminimi i servitutit sezonal – qasja në pronë përmes pronës së dikujt tjetër', janë vlerësuar pak mbi mesatare. Në Matricën 28, prioriteti me vlerësimin më të lartë krahas prioritetit Komunal në fjalë, është 'Rritja e numrit të objekteve të deponimit dhe magazinimit përmasive Publiko-Private', i cili është konsideruar i një rëndësie të madhe.

MATRICA 28: BUJQËSIA – KOMUNA E DRENASIT

	Qeveria	Komuna	Zgjerimi i mbulueshmërisë së sistemit të ujitjes së paku në 40% të tokës së punueshme deri në 2021	Krijimi i platformës së Sistemit të Integruar Informativ Bujqësor për ta rritur konkurrueshmërinë	Zgjidhja e çështjes së tokave bujqësore të fragmentuara	Rritja e numrit të objekteve të deponimit dhe magazinimit përmasive Publiko-Private	Rritja e numrit të njësive të testimit laboratorik për cilësinë e prodhimit privat të farërave	Financimi i projektit të rregullimit të tokës dhe integrimi në projektet e zhvillimit rural	Reforma strukturore me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për rritjen e prodhimtarisë bujqësore	Krijimi i ngastrave në formë të rregullt gjeometrike dhe realizimi i projektit të Sistemit të Identifikimit të Parcelave (LPIS)	Formimi i rrjetit të rrugëve fushore dhe eliminimi i servitutit sezonal – qasja në pronë përmes pronës së dikujt tjetër
Krijimi i një sistemi sektorial bujqësor intensiv dhe të qëndrueshëm ekonomikisht	6	7	3	8	1	1	6	7	7		
Sektorializimi dhe zbatimi i kriterëve në dhënie e subvencioneve për fermerët	1	4	5	5	6	4	4	5	5		
Përkrahja e zhvillimit të agrobiznesit, duke synuar nxitjen e ndërtimit të Identitetëve dhe brendëve	1	4	2	2	5	4	5	3	4		
Zhvillimi i agro-biznesit, përmes ngritjes së mini -serave	7	6	5	5	6	5	6	4	4		
Mbështeten fermerët në ngritjen e sistemit të ujitjes	8	4	4	3	4	4	6	5	4		
ngritjes së kapaciteteve përpunuese dhe distribuimit të produkteve bujqësore	5	4	5	5	5	6	4	2	2		
Përmirësimi i sistemit të ujitjes së tokave bujqësore	9	5	5	4	4	5	4	4	3		
Zhvillimi dhe avancimi i programeve për trajnimin e fermerëve	4	6	3	3	5	3	4	3	3		




VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)





Zyrtarët e komunës së Drenasit janë pyetur po ashtu se a kanë bashkëpunuar apo janë konsultuar me zyrtarë të nivelit qendror në hartimin e këtyre prioriteteve Komunale. Sipas tyre, nuk ka pasur konsultime lidhur me këto, prioritetet janë përpiluar në bazë të specifikave të komunës. Diskutime dhe konsultime me zyrtarët qeveritar ka më së shumti gjatë kohës së përpilimit të buxhetit Komunal. Komunikimi me nivelin qendror përgjithësisht është i një niveli të kënaqshëm, por sipas tyre duhet të ketë përparim të mëtutjeshëm në këtë drejtim. Drejtorët e Zhvillimit Ekonomik të të gjitha Komunave takohen tri deri katër herë në vit, por Ministri i Zhvillimit Ekonomik nuk merr pjesë çdo herë. Këta mendojnë se është e rëndësishme që këto takime të jenë më të shpeshta dhe më efektive, në mënyrë që zyrtarët Komunal të kenë hapësirë t'i adresojnë problemet dhe vërejtjet dhe të gjejnë zgjidhje bashkërisht.



9. KOMUNA E SHTIMES

Komuna e Shtimes është e fokusuar në tri lëmi kryesore me më së shumti prioritet për zhvillim të përgjithshëm të komunës:

1. **Zhvillimi ekonomik,**
2. **Arsimi dhe**
3. **Shëndetësia.**

Këto janë caktuar si tri lëmit për komunën gjatë hartimit të Planit Zhvillimor 2009-2020 dhe Strategjive Sektoriale të Zhvillimit (p.sh. Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Arsimit). Këto dokumente strategjike mbesin si bazë për koordinimin e aktiviteteve të komunës si dhe udhërrëfyes për përpilimin e buxheteve përkatëse. Në rastet kur paraqitet nevoja për të bërë ndryshime në aktivitetet e komunës, krijohen versione të reja të buxhetit, me ndryshime që gjithnjë mbesin të ankoruara në Plan Zhvillimor Komunal.

9.1 Kapitali njerëzor

Duke ndjekur metodologjinë e studimit, për të vlerësuar kohezionin mes qeverisjes lokale edhe asaj qendrore, në Komunën e Shtimes është bërë intervistë me zyrtarë të drejtorive të ndryshme relevante. Fillimisht, pasi janë konsultuar dokumentet strategjike Komunale, janë listuar prioritetet e komunës për dy vitet e ardhshme në katër kategori: 'Zhvillimi i kapitalit njerëzor', 'Zhvillimi i Industrive Konkurruese', 'Zhvillimi i Infrastrukturës', dhe 'Zhvillimi i Bujqësisë'. Katër kategoritë për vlerësim janë caktuar në akordim me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021.

Në komunën e Shtimes kemi të renditura këto prioritetet për kategorinë e kapitalit njerëzor: 1) Plotësimi në masën 80 përqind i kushteve për organizimin e mësimdhënies dhe të nxëniet sipas standardeve të shek. XXI, 2) Institucionet e arsimit para universitar të krijojnë siguri, pamje pedagogjike, humane dhe të, 3) Arsimi para universitar i Shtimes të ketë 12 karakteristika të institucioneve efektive-cilësore, 4) Krijimi i mekanizmave për avancimin e të drejtave të fëmijëve, 5) Sigurimi i mekanizmave për monitorim, mbikëqyrje dhe vlerësimin e performancës së punës së institucioneve të AP-së dhe të arritjeve të nxënësve, dhe 6) Institucionet e AP-së të posedojnë programet e rinovimit dhe të avancimit të përhershëm të institucioneve të AP-së.

Sipas vlerësimeve nga Komuna e Shtimes për rëndësinë e prioritetet qeveritare në sektorin e kapitalit njerëzor krahas prioritetet të komunës në po të njëjtin sektor del se, prioriteti i parë qeveritar 1) Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucione paras-hkollore, nuk është fare relevant me prioritetin e parë të komunës 1) Plotësimi me masën 80 përqind të kushteve për organizimin e mësimdhënies dhe të nxëniet sipas standardeve të shek. XXI. Mirëpo, i njëjti prioritet qeveritar vlerësohet të jetë mjaft relevant në kuadër të prioritetit të tretë Komunal, atë të 12 karakteristikeve të institucioneve efektive-cilësore, dhe me prioritetin 4) Krijimi i mekanizmave për avancimin e të drejtave të fëmijëve.

Për prioritetin e dytë Komunal, 2) Institucionet e arsimit para universitar të krijojnë siguri, pamje pedagogjike, humane dhe të shëndetshme, përveç prioritetet, 6) Ulja e nivelit të punësimit joformal dhe 7) Angazhimi afatshkurtër i ekspertëve dhe studentëve të diasporës, që nuk janë fare relevante, të gjitha prioritetet e tjera qeveritare janë të një rëndësie të lartë (shih Matricën 29).

Ngritja e efektshmërisë dhe cilësisë së institucioneve para universitarë përmes 12 karakteristikave (për të përmendur disa: krijimi i udhëheqjeve të forta dhe profesionale në institucione arsimore, përcjellja-monitorimi, mbikëqyrja dhe vlerësimi i performancës, Avancimi dhe promovimi i përgjegjësive dhe të drejtave të fëmijës) përputhet mjaft shumë me secilin prioritet qeveritar. Përputhshmërinë më të lartë krahas këtij prioriteti e ka prioriteti i dytë qeveritar 2) Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm.

Tutje, të gjitha prioritetet qeveritare janë vlerësuar të jenë të një përputhshmërie të lartë krahas prioritetit të katërt Komunal, përkatësisht krahas 4) Krijimit të mekanizmave për

avancimin e të drejtave të fëmijëve. Njëjte, edhe prioriteti i pestë Komunal, 5) Sigurimi i mekanizmave për monitorim, mbikëqyrje dhe vlerësimin e performancës së punës së institucioneve të AP-se dhe të arritjeve të nxënësve, është vlerësuar të ketë përputhje me pothuajse të gjitha prioritetet qeveritare. Dhe në fund, prioriteti i gjashtë Komunal, 6) Institucionet e AP-se të posedojnë programet e inovacionit dhe të avancimit të përhershëm të institucioneve të AP-se, është vlerësuar të ketë një përputhje me të ulet me prioritetet qeveritare në krahasim me prioritetet e tjera Komunale. Përmirësimi i planifikimit të shpenzimeve në sistemin e arsimit është vlerësuar me notën më të lartë të rëndësisë krahas prioritetit të gjashtë Komunal.

MATRICA 29: KAPITALI NJERËZOR – KOMUNA E SHITES

	Komuna	Qeveria	Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucione parashkollore	Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm	Përmirësimi i ndërlidhjes ndërmjet shkathësive të fituara në arsim dhe kërkesave të tregut të punës	Forcimi i funksioneve të provimit, inspektimit dhe akreditimit në sistemin arsimor	Përmirësimi i planifikimit të shpenzimeve në sistemin e arsimit	Ulja e nivelit të punësimit joformal	Angazhimi afatshkurtër i ekspertëve dhe studentëve të diasporës
Plotësimi në masën 80% i kushteve për organizimin e mësimdhënies dhe të nxënësve sipas standardeve të shek XXI	1	6	3	6	5	2	1		
Institucionet e arsimit para-universitar të krijojnë siguri, pamje pedagogjike, humane dhe të shëndetshme	6	7	5	6	7	1	1		
Arsimi para-universitar i Shites të ketë 12 karakteristika të institucioneve efektive-cilësore	8	9	5	6	8	5	4		
Krijimi i mekanizmave për avancimin e të drejtave të fëmijëve	8	8	6	8	9	6	4		
Sigurimi i mekanizmave për monitorim, mbikëqyrje dhe vlerësimin e performancës së punës së institucioneve të Arsimit Para-universitar (AP) dhe të arritjeve të nxënësve	5	7	8	7	9	4	4		
Institucionet e AP të posedojnë programet e inovacionit dhe të avancimit të përhershëm të institucioneve të AP-se	5	7	6	6	8	4	4		

* VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)

1 2 3 4 5 6 7 8 9

9.2 Industritë konkurruese

Në kategorinë e dytë, 'Zhvillimi i industrive konkurruese', prioritetet e Komunës së Shtimes janë: 2.1. 'Krijimi i katër zonave të biznesit me kapacitet prej 70 bizneseve deri në vitin 2018', 2. 'Zvogëlimi i informalitetit në masën 50 për qind deri në vitin 2018', 2.3. 'Trajnimi/këshillimi i 50 sipërmarrësve në fushën e hartimit të planeve të biznesit dhe planeve investive deri në vitin 2015', 2.4. 'Hartimi i guidave për promovimin e biznesit deri në vitin 2014', dhe 2.5. 'Zhvillimi i Turizmit' (Matricën 30).

Nga vlerësimi që iu bë këtyre prioritetëve të komunës për të treguar shkallën e lidhshmërisë me prioritetet e qeverisë, doli një përputhshmëri kryesisht e ulët. Në veçanti vërehet dukshëm një mospërputhje me tri prioritetet e nivelit qendror. 'Zgjidhja e çështjes së tokave bujqësore të fragmentuara', 'Zhbllokimi i fondit të privatizimit dhe përdorimi i mjeteve për

zhvillim', dhe 'Qeverisje e mirë dhe performancë e kënaqshme e korporatave me aksione shtetërore' janë tri prioritetet qeveritare që në mesatare janë vlerësuar me shkallën dy sa i përket përputhshmërisë së tyre ndaj prioritetëve Komunale. Një nga arsyt e kësaj mospërputhje është fakti që në komunën e Shtimes nuk ka ndërmarrje me aksione shtetërore për të cilat ka prirje posaçërisht të madhe për ndikimin e tyre në klimën ekonomike në komunë. Prandaj, politikat që kanë të bëjnë me menaxhimin e ndërmarrjeve publike janë të një rëndësie të ulët për Komunën e Shtimes. Në ndërkohë, prioriteti qeveritar me përputhshmërinë më të lartë është 'Rritja e nivelit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) dhe atyre të diasporës', vlerësimi i të cilit ka treguar rëndësi të lartë të IHD-ve sidomos në promovimin e bizneseve dhe zhvillimin e turizmit.

MATRICA 30: INDUSTRIË KONKURRUESE – KOMUNA E SHTIMES

Komuna	Qeveria	Lehtësimi e qasjes në financa për ndërmarrjet kosovare	Rrjetëzimi dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të grupuara	Kalimi i NVM-ve në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar	Rritja e nivelit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) dhe atyre të diasporës	Zgjidhja e çështjes së tokave bujqësore të fragmentuara	Zhbllokimi i fondit të privatizimit dhe përdorimi i mjeteve për zhvillim	Qeverisje e mirë dhe performancë e kënaqshme e korporatave me aksione shtetërore
Krijimi i katër zonave të biznesit me kapacitet prej 70 bizneseve deri në vitin 2018		7	5	6	5	1	1	1
Zvogëlimi i informalitetit në masën 50% deri në vitin 2018		5	1	2	6	1	1	1
Trajnimi/këshillimi i 50 sipërmarrësve në fushën e hartimit të planeve të biznesit dhe planeve investive deri në vitin 2015		1	2	3	5	1	1	4
Hartimi i guidave për promovimin e biznesit deri në vitin 2014		6	1	1	8	4	1	2
Zhvillimi i turizmit		6	7	6	8	6	1	1



VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)



9.3 Infrastruktura

Në kategorinë e 'Zhvillimit të Infrastrukturës', Komuna e Shtimes ka gjithsej 7 prioritete (Matricën 31). Në mesin e tyre, prioritetet e rëndësishme më të lartë janë: 3.1. 'Kompletimi i planeve rregulluese dhe infrastrukturës fizike (rrugë, trotuare, kanalizime, ndriçim publik, shenjëzimi, tregjeve, stacionet e autobusëve, ndërtesat Komunale, lumenj)', 3.2. 'Funksionalizimi i mjekësisë familjare në të gjithë territorin e komunës së Shtimes deri në vitin 2017', 3.3. 'Dixhitalizimi i të gjitha shërbimeve publike brenda periudhës kohore 2014-2018', 3.4. 'Krijimi i 30 ha hapësirë të gjelbër në qytet dhe fshatra deri në vitin 2018', 3.5. 'Kompletimi i infrastrukturës shkollore (ndërtimi i objekteve, pajisjeve, laboratorëve dhe mjeteve të tjera përcjellëse) deri në vitin 2018'. Brenda kësaj kategorie hyjnë shumica e investimeve kapitale, dhe buxheti Komunal që ndahet brenda vitit për këtë kategori është rreth 25 përqind e buxhetit total.

Përsëri, edhe në këtë kategori, vërehet një vlerësim i ulët i përputhshmërisë së prioriteteve Komunale të Shtimes me ato qeveritare në krahasim me Komunat tjera. Prioriteti i parë i komunës së Shtimes në zhvillim të infrastrukturës, 'Kompletimi i planeve rregulluese dhe infrastrukturës fizike (rrugë, trotuare, kanalizime, ndriçim publik, shenjëzimi, tregjeve, stacionet e autobusëve, ndërtesat Komunale, lumenj)', është vlerësuar me rreth dy shkallë nga intensiteti i mundshëm një deri në nëntë. Ky prioritet i komunës është mesatarisht relevant vetëm ndaj dy prioriteteve qendrore të cilat janë 'Investimi në masa të eficientës për konsumin e energjisë' dhe 'Rritja e përdorimit të teknologjisë informative në operimet e bizneseve, shkollave dhe institucioneve publike'.

MATRICA 31: INFRASTRUKTURA – KOMUNA E SHTIMES

	Komuna	Qeveria	Rritja e kapacitetit vendor të prodhimit të energjisë elektrike nga linjiti dhe burimet e ripërtëritshme	Investimi në masa të eficientës për konsumin e energjisë	Përfundimi i akseve kryesore ndërkombëtare dhe rajonale rrugore si dhe linja ndërkombëtare hekurudhore	Rritja e përdorimit të teknologjisë informative në operimet e bizneseve, shkollave dhe institucioneve publike	Përmirësimi i infrastrukturës mbështetëse për prodhimtarinë bujqësore	Racionalizimi i përdorimit të ujit dhe rritja e kapaciteteve prodhuese dhe shpërndarëse	Sigurimi i përdorimit të qëndrueshëm të pyjeve të Kosovës	Menaxhimi më i qëndrueshëm i mbeturinave
Kompletimi i planeve rregulluese dhe infrastrukturës fizike (rrugë, trotuare, kanalizime, ndriçim publik, shenjëzimi, tregjeve, stacionet e autobusëve, ndërtesat Komunale, lumenj)	1	5	1	5	1	3	1	2		
Funksionalizimi i mjekësisë familjare në të gjithë territorin e komunës së Shtimes deri në vitin 2017	1	3	1	4	1	3	1	1		
Dixhitalizimi i të gjitha shërbimeve publike brenda periudhës kohore 2014-2018	2	5	1	5	1	3	1	2		
Krijimi i 30 ha hapësirë të gjelbër në qytet dhe fshatra deri në vitin 2018	1	2	1	1	2	3	4	6		
Kompletimi i infrastrukturës shkollore (ndërtimi i objekteve, pajisjeve, laboratorëve dhe mjeteve të tjera përcjellëse) deri në vitin 2018	1	5	2	5	2	3	1	2		
Ngritja e kapaciteteve profesionale të burimeve njerëzore që ofrojnë shërbimet publike përmes trajnimeve, vizitave studimore dhe edukimit formal	3	4	2	6	5	5	5	6		
Funksionalizimi i Sistemit të menaxhimit të cilësisë në të gjitha institucionet publike të komunës së Shtimes deri në vitin 2018	1	3	1	8	3	2	2	2		



VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)



9.4 Bujqësia

Në kategorinë e fundit, atë të Zhvillimit Bujqësor, prioritetet kryesore në Komunën e Shtimes në përgjithësi kanë të bëjnë me mbështetjen e drejtpërdrejtë të fermerëve përmes subvencioneve të ndryshme. Më specifikisht, prioritetet e komunës janë: 4.1. 'Zgjerimi i sipërfaqeve nën ujitje nga 100 në 400 ha, deri në vitin 2018', 4.2. 'Subvencionimi i 20 fermerëve në vlerë prej 150,000 euro për ndërtimin ose zgjerimin e serave deri në vitin 2018', 4.3. 'Subvencionimi i 30 fermerëve (pemtari, blegtori) në një vlerë prej 250,000 euro deri në vitin 2018', 4.4. 'Këshillimi dhe trajnimi i 100 fermerëve për zhvillimin e bujqësisë intensive deri në vitin 2016', 4.5. 'Mbështetja dhe subvencionimi me një vlerë 100,000 euro i ngritjes së kapaciteteve përpunuese dhe distribuimit të produkteve bujqësore deri në vitin 2016'.

Sa i përket vlerësimeve të përputhjes së prioritetëve të qeverisë lokale dhe asaj qendrore, gjatë intervistës në Shtime doli se në krahasim me tri kategoritë e prioritetëve të vlerësuara në këtë studim, prioritetet e caktuara brenda kategorisë së Zhvillimit Bujqësor në komunë konsiderohen të kenë përputhjen më të lartë me prioritetet e qeverisë qendrore.

Të gjitha prioritetet e komunës në këtë kategori konsiderohen të kenë lidhshmëri më të lartë me prioritetin 'Formimi i rrjetit të rrugëve fushore, që mundësojnë qasje të drejtpërdrejtë në parcela, si dhe eliminimi i servitutit sezonal – qasja në pronë përmes pronës së dikujt tjetër', meqë rast është dhënë një vlerësim prej shtatë shkallësh. Në anën tjetër prioriteti nga Komuna, i cili në përgjithësi është vlerësuar me shkallë më të lartë të rëndësisë krahas prioritetëve të qeverisjes qendrore, është 4.5. 'Mbështetja dhe subvencionimi me një vlerë 100,000 euro i ngritjes së kapaciteteve përpunuese dhe distribuimit të produkteve bujqësore deri në vitin 2016', që është vlerësuar të ketë përputhshmëri prej nëntë shkallësh ndaj prioritetit të qeverisë 'Rritja e numrit të objekteve të deponimit dhe magazinimit në rajonet kryesore të Kosovës përmes Partneriteteve Publiko-Private' dhe prioritetit 'Rritja e numrit të njëjësive të testimit laboratorik për cilësinë e prodhimit privat të farërave dhe përmirësimi i standardeve fito sanitare'.

MATRICA 32: BUJQËSISË – KOMUNA E SHTIMES

	Qeveria	Komuna	Zgjerimi i mbulueshmërisë së sistemit të ujitjes së paku në 40% të tokës së punueshme deri në 2021	Krijimi i platformës së Sistemit të Integruar Informativ Bujqësor për ta rritur konkurrencshmërinë	Zgjidhja e çështjes së tokave bujqësore të fragmentuara	Rritja e numrit të objekteve të deponimit dhe magazinimit përmes Partneriteteve Publiko-Private	Rritja e numrit të njëjësive të testimit laboratorik për cilësinë e prodhimit privat të farërave	Financimi i projektit të rregullimit të tokës dhe integrimi në projektet e zhvillimit rural	Reforma strukturore me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për rritjen e prodhimtarisë bujqësore	Krijimi i ngastrave në formë të rregullt gjeometrike dhe realizimi i projektit të Sistemit të Identifikimit të Parcelave (LPIS)	Formimi i rrjetit të rrugëve fushore dhe eliminimi i servitutit sezonal – qasja në pronë përmes pronës së dikujt tjetër
Zgjerimi i sipërfaqeve nën ujitje nga 100 në 400 ha, deri në vitin 2018	4	5	5	1	2	5	5	6	6		
Subvencionimi i 20 fermerëve në vlerë prej 150000 euro për ndërtimin ose zgjerimin e serave deri në vitin 2018	4	3	5	6	6	5	6	5	7		
Subvencionimi i 30 fermerëve (pemtari, blegtori) në një vlerë prej 250000 euro deri në vitin 2018	4	3	5	6	6	5	6	5	7		
Këshillimi dhe trajnimi i 100 fermerëve për zhvillimin e bujqësisë intensive deri në vitin 2016	5	6	5	7	7	8	6	7	8		
Mbështetja dhe subvencionimi me një vlerë 100000 euro i ngritjes së kapaciteteve përpunuese dhe distribuimit të produkteve bujqësore deri në vitin 2016	5	6	5	9	8	5	5	6	7		



VLERËSIMI ME SHKALLË PREJ 1 DERI 9 I RËNDËSISË DHE PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE QENDRORE ME ATO KOMUNALE (KU 1 PARAQET RËNDËSI MË TË ULËT, 9 RËNDËSI MË TË LARTË)





Nga intervista në Shtime u kuptua se konsultimet me qeverinë qendrore kryesisht kanë munguar gjatë dizajnit të prioriteteve të qeverisjes lokale. Mirëpo për të siguruar kohezion mes dy niveleve të qeverisjes, Komuna ka bërë hartim të strategjisë Komunale duke iu referuar dhe përshtatur strategjive kombëtare. Ngjashëm me Komunat e tjera, komunikimi me qeverinë qendrore dhe takimet realizohen përmes Asociacionit të Komunave, drejtorive të njëjta Komunale edhe ministrive të linjës. Këto takime janë megjithatë të rralla. Mbështetja e dhënë nga Komuna në anën tjetër konsiderohet si e kënaqshme dhe kryesisht e drejtuar në fushën e infrastrukturës, ndërtimit të rrugëve dhe objekteve.

PËRMBYLLJA

Qëllimi i këtij studimi ishte të identifikojë dhe vlerësojë përputhshmërinë e prioriteteve të zhvillimit rajonal (konkretisht rajonit ekonomik Qendër) dhe prioriteteve kombëtare të adresuara nga Qeveria qendrore. Identifikimi i prioriteteve të Komunave në rajonin Qendër është bërë i mundur përmes dokumenteve strategjike të hartuara nga vetë Komunitat, si dhe janë mbledhur informata për prioritete kryesisht nga intervistat me zyrtarë të drejtorive të Zhvillimit Ekonomik, të Arsimit, dhe të Bujqësisë.

Zhvillimi ekonomik dhe i qëndrueshëm është identifikuar si prioritet i përbashkët për të gjitha Komunitat e përfshira në studim. Prioritetet e tjera, siç është zhvillimi i infrastrukturës, arsimit dhe bujqësia janë konstatuar të jenë prioritet për më shumë se gjysmën e Komunave të rajonit Qendër. Komunitat të cilat e kanë për prioritet konkretisht zhvillimin e infrastrukturës janë: Prishtina, Fushë Kosova, Obiliqi, Graçanica dhe Lipjani. Për zhvillimin e mëtutjeshëm të arsimit dhe kapaciteteve njerëzore janë të angazhuara seriozisht dhe e kanë theksuar si prioritet lokal Komunitat në vijim: Fushë Kosova, Drenasi, Graçanica, Lipjani, Drenasi dhe Shtimja. Nga intervistat është vërejtur ngritja e angazhimit në zhvillimin e bujqësisë, si degë e rëndësishme e ekonomisë në vend, në pothuajse të gjitha Komunitat e rajonit Qendër, konkretisht, këtë e kanë prioritetizuar Komunitat: Prishtina, Podujeva, Fushë Kosova, Graçanica dhe Lipjani. Vlen të ceket se përmirësimi dhe mbrojtja e mjedisit është theksuar të jetë me prioritet për Komunitat Fushë Kosovë dhe Obiliq. Në këto dy Komunitat shtrihet hapësira industriale energjetike, e cila po ashtu njihet si zona më e ndotur në Kosovë. Rrjedhimisht, arsyeshëm këto dy Komunitat kanë vënë për prioritet ngritjen e nivelit të mbrojtjes së mjedisit dhe ambientit.

Krahas identifikimit të prioriteteve të përbashkëta Komunale, janë identifikuar edhe prioritetet qendrore me përputhshmëri më të lartë për Komunitat e ndryshme. Më saktësisht, ky identifikim është realizuar duke iu referuar katër shtyllave të SKZH-së, gjegjësisht kapitali njerëzor, industrinë konkurruese, zhvillimi i infrastrukturës dhe bujqësia. Për shtyllën e kapitalit njerëzor, prioriteti qendror i vlerësuar me përputhshmëri më të lartë krahas shumicës së prioriteteve të tetë Komunave, del të jetë “Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm”, i pasuar nga prioritetet qendrore “Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucione parashkollore” dhe “Përmirësimi i ndërlidhjes ndërmjet shkollësive të fituara në arsim dhe kërkesave të tregut të punës”. Ngjashëm, për shtyllën e industrisë konkurruese, prioritetet qendrore me përputhshmëri më të lartë krahas atyre Komunale janë: “Rritja e nivelit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) dhe atyre të diasporës”; “Kalimi i NVM-ve në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar”; dhe “Rrjetëzimi dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të grupuara”. Gjithashtu, identifikimi i prioriteteve për infrastrukturën ka nxjerrë rezultatet si në vijim: “Racionalizimi i përdorimit të ujit dhe rritja e kapaciteteve prodhuese dhe shpërndarëse”; “Përmirësimi i infrastrukturës mbështetëse për prodhimtarinë bujqësore”; dhe “Rritja e përdorimit të teknologjisë informative në operimet e bizneseve, shkollave dhe institucioneve publike”, kanë rezultuar më relevantet krahas prioriteteve Komunale. E fundit, prioritetet të nivelit qendror në bujqësi: “Rritja e numrit të objekteve të deponimit dhe magazinimit në rajonet kryesore të Kosovës përmes Partneriteteve Publiko-Private”; “Zgjerimi i mbulueshmërisë së sistemit të ujitjes së paku në 40përqind të tokës së punueshme deri në vitin 2021”; dhe “Krijimi i ngastrave në formë sa më të rregullt gjeometrike, të përshtatshme për

përdorim të lehtë të mekanizmit bujqësorë, si dhe do të realizohet projekti i Sistemit të Identifikimit të Parcelave (LPIS)”, janë vlerësuar me përputhshmërinë më të lartë në raport me prioritetet lokale të tetë Komunave në fjalë.

Nga ky vlerësim doli se në përgjithësi ka një përputhshmëri jo të lartë mes prioritetëve të Komunave të rajonit Qendër dhe prioritetëve të Qeverisë qendrore. Posaçërisht ka një mungesë të përputhshmërisë në kategoritë e zhvillimit të infrastrukturës dhe zhvillimit të bujqësisë. Në këto dy kategori përputhshmëria është vlerësuar si shume e ulët në të gjitha Komunat (me përjashtim të zhvillimit të infrastrukturës në Graçanicë). Përputhshmëria është më e larta (mesatare ose mbi mesatare) në kategoritë e zhvillimit të kapitalit njerëzor dhe zhvillim të industrive konkurruese për Komunat e Prishtinës, Podujevës, dhe Graçanicës.

Ndërsa një koherencë minimale ekziston mes prioritetëve të qeverisjes lokale dhe atyre të Qeverisë qendrore në komunën e Fushë Kosovës dhe komunën Drenasit- ku përputhshmëria e prioritetëve është vlerësuar si minimale në të gjitha kategoritë e zhvillimit.

Sigurisht, gjetja e një mungese të përputhshmërisë së prioritetëve në dy nivelet e qeverisjes në vetvete nuk është dëshmi e plotë e mungesës së një kontributi të përbashkët të Komunave dhe Qeverisë drejt një zhvillimi kombëtar. Por, mungesa e përputhshmërisë është një indikator i qartë që në planifikim strategjik të niveleve të ndryshme të qeverisjes mungon koordinim që do të stimulonte një sinergji të zhvillimit kombëtar.

Përgjithësisht, ndërlidhja e prioritetëve qendrore në raport me prioritetet Komunale ka hapësirë për bashkërendim, për shkak

se të dhënat nga intervistat sugjerojnë që bashkëpunimi mes nivelit qendror dhe Komunal në shumicën e rasteve është i kënaqshëm, por që ky bashkëpunim mund të ngritet. Kështu, kjo përkon edhe me qëllimin e përcaktuar në SKZH për krijimin e një boshti të përbashkët orientues të bazuar në strategjitë dhe politikat ekzistuese, kështu për të përzgjedhur 'prioritetet më të larta të vendit'.

Prandaj, rekomandimi kryesor është krijimi i një modaliteti të bashkëpunimit mes Qeverisë dhe Komunave për të identifikuar hapësirat për planifikim të përbashkët zhvillimor që do të asistonte në një rritjeje ekonomike dhe zhvillimi të përsheptuar. Kjo mund të arrihet përmes takimeve më të shpeshta dhe bashkëpunimit gjatë hartimit të dokumenteve strategjike.

REFERENCAT

- Babatinca, E., Udhëheqës i sektorit për Zhvillim Ekonomik (03.06.2016). Intervistë personale.
- Berjani, E., Drejtor për Zhvillim Ekonomik Fushë Kosovë (18.07.2016). Intervistë personale.
- Çerkini, S., Drejtor për Zhvillim Ekonomik Shtime (04.07.2016). Intervistë personale.
- Fetahu, A., Drejtor për Zhvillim Ekonomik Podujevë (03.06.2016). Intervistë personale.
- Gërguri, B., Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencës Obiliq (22.06.2016). Intervistë personale.
- Hasi, S., Drejtor për Zhvillim Ekonomik Drenas (16.06.2016). Intervistë personale.
- Mihajlovic, A., Drejtor për Zhvillim Ekonomik Graçanicë (22.06.2016). Intervistë personale.
- Komuna e Drenasit (2014). Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2015-2019. Drenas, Kosovë.
- Komuna e Fushë Kosovës (2016). Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2016-2020. Fushë, Kosovë.
- Komuna e Graçanicës (2014). Plani Zhvillimor Komunal 2014-2029. Graçanicë, Kosovë.
- Komuna e Lipjanit (2012). Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2012-2017. Lipjan, Kosovë.
- Komuna e Podujevës (2015). Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2016-2018. Podujevë, Kosovë.
- Komuna e Prishtinës (2013). Planin Zhvillimor Komunal Prishtinë 2012-2022. Prishtinë, Kosovë.
- Komuna e Shtimes (2009). Plani Zhvillimor Komunal 2009-2020. Shtime, Kosovë.
- Komuna e Obiliqit (2009). Plani Zhvillimor Komunal 2009-2020. Obiliq, Kosovë.
- Ramadani, L., Drejtor për Zhvillim Ekonomik Lipjan (24.06.2016), Intervistë personale.
- Sejdiu, D., Nënkrjetar i Komunës së Prishtinës (07.07.2016), Intervistë personale.
- Qeveria e Kosovës (2016). Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021. Prishtinë, Kosovë.

SHTOJCA

Prioritetet e SKZH-së të mbuluara në këtë studim hyjnë në katër shtyllat tematike: zhvillimi i kapitalit njerëzor, zhvillimi i industrive konkurruese, zhvillimi i infrastrukturës, si dhe zhvillimi i bujqësisë, të cilat janë të renditura në vijim:

Në kuadër të kapitalit njerëzor janë përcaktuar këto prioritetet:

- Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucione parashkollore
- Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm
- Përmirësimi i ndërlidhjes ndërmjet shkathtësive të fituara në arsim dhe kërkesave të tregut të punës
- Forcimi i mekanizmave të llogaridhënies dhe certifikimit në sistemin arsimor
- Përmirësimi i planifikimit të shpenzimeve në sistemin e arsimit
- Ulja e nivelit të punësimit joformal
- Angazhimi konkret i ekspertëve dhe studentëve të diasporës

Në kuadër të zhvillimit të industrive konkurruese janë përcaktuar këto prioritetet:

- Lehtësimi e qasjes në financa për ndërmarrjet kosovare
- Rrjetëzimi dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të grupuara
- Kalimi i NVM-ve në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar
- Rritja e nivelit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) dhe atyre të diasporës
- Zgjidhja e çështjes së tokave bujqësore të fragmentuara
- Zhbllkimi i fondit të privatizimit dhe përdorimi i mjeteve për zhvillim
- Qeverisje e mirë dhe performancë e kënaqshme e korporatave me aksione shtetërore

Në kuadër të zhvillimit të infrastrukturës janë përcaktuar këto prioritetet:

- Rritja e kapacitetit vendor të prodhimit të energjisë elektrike nga linjiti dhe burimet e ripërtëritshme
- Investimi në masa të eficientës për konsumin e energjisë
- Përfundimi i akteve kryesore ndërkombëtare dhe rajonale rrugore si dhe linja ndërkombëtare hekurudhore

- Rritja e përdorimit të teknologjisë informative në operimet e bizneseve, shkollave dhe institucioneve publike
- Përmirësimi i infrastrukturës mbështetëse për prodhimtarinë bujqësore
- Racionalizimi i përdorimit të ujit dhe rritja e kapaciteteve prodhuese dhe shpërndarës
- Sigurimi i përdorimit të qëndrueshëm të pyjeve të Kosovës
- Menaxhimi më i qëndrueshëm i mbeturinave

Në kuadër të zhvillimit të bujqësisë janë përcaktuar këto objektiva:

- Zgjerimi i mbulueshmërisë së sistemit të ujitjes së paku në 40përqind të tokës së punueshme deri në vitin 2021
- Krijimi i platformës informative të Sistemit të Integruar Informativ Bujqësor për ta rritur konkurrueshmërinë në sektorin e bujqësisë
- Zgjidhja e çështjes së tokave bujqësore të fragmentuara
- Rritja e numrit të objekteve të deponimit dhe magazinimit në rajonet kryesore të Kosovës përmes Partneriteteve Publiko-Private
- Rritja e numrit të njërive të testimit laboratorik për cilësinë e prodhimit privat të farërave dhe përmirësimi i standardeve fito-sanitare
- Përgatitja dhe financimi i projektit të rregullimit të tokës dhe integrimi në projektet e zhvillimit rural
- Ndërmarrja e reformave strukturore (me theks në masa ligjore dhe institucionale) me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për rritjen e prodhimtarisë bujqësore
- Krijimi i ngastrave në formë sa më të rregullt gjeometrike, të përshtatshme për përdorim të lehtë të mekanizmit bujqësorë, si dhe do të realizohet projekti i Sistemit të Identifikimit të Parcelave (LPIS)
- Formimi i rrjetit të rrugëve fushore, që mundësojnë qasje të drejtpërdrejtë në parcela, si dhe eliminimi i servitutit sezonal – qasja në pronë përmes pronës së dikujt tjetër



Projekt i mbështetur nga BE
dhe i menaxhuar nga
Zyra e BE-së në Kosovë

Implementuar nga:



**FRIEDRICH
EBERT**

STIFTUNG

PËRPUTHSHMËRIA E PRIORITETEVE TË QEVERISË QENDRORE ME ATO TË QEVERIVE LOKALE TË RAJONIT QENDËR



Projekt i mbështetur nga BE
dhe i menaxhuar nga
Zyra e BE-së në Kosovë

Implementuar nga:



**FRIEDRICH
EBERT**
STIFTUNG